



Npi – 01/90 datë: 26.02.2024

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 26.02.2024, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -II- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E thirrur për datën: 26.02.2024, (e hënë) në ora 09.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Reshat Mujota, dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu; Drejtorët; Shefja e Kabinetit znj.Anita Kurti; Nga ZKF-znj.Kimete Ukaj; Nga RZSH z.Muhamet Hoxha; Asistente e Kryesuesit të Kuvendit znj.Gentiana Mehmeti; Zyrtarët e IT-së; Zyrtarë e Informimit znj.Vlora Hyseni; Praktikantet, znj.Valmira Hoxha, znj.Sadbere Halili dhe znj.Donjeta Qorrolli.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 31.01.2024,
2. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, (pas diskutimit Publik)
3. Informatë për zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për 2022,
4. Prop-Vendim për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024,
5. Prop-Vendim për formimin e Komisioneve për ndarjen e çmimeve “Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi”.
6. Prop-vendim për caktimin e çelësit për zgjedhjen e komisioneve për ndarjen e çmimeve “Sakrifica Reçakut-1999” dhe “Pena e Artë”.
7. Draft-Rregullore Komunale për Transparencë, (pas diskutim publik),
8. Draft-Plani i veprimit për transparencë komunale 2024-2028, (pas diskutim publik),
9. Draft-Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës 2024-2026,
10. Pyetje – Përgjigje,
11. Informatë nga DKA për përfundimin e gjysmë - vjetorit të parë shkollor 2023/24,
12. Informatë nga DPUKGJ lidhur me legalizimin e objekteve pa leje ndërtimi,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje për Kryetarin, te pikat e rendit të ditës jemi pajtuar që të vinë sipas planit të punës së Kuvendit dhe i ke pru të gjitha ashtu siç janë në plan të punës. Në vitin 2015 pikërisht asamblistët e LVV-së e kanë kërkuar një pikë shtesë të jetë “të ndryshme” që të jetë si pikë e fundit e rendit të ditës, ku nga asamblistët e juaj është kërkuar që të jetë bile pika e dytë mbas procesverbalit. Ju si Kryesues jeni zotuar në mbledhjen e kaluar që në mbledhjet e radhës të jetë si pikë e dytë mbas procesverbalit çka është ka ndodhur këtu ose ke bërë gabim teknik, unë nuk e besoj që je tu na mashtruar këtu, ku e ki premtimin që na ke dhënë, por po besoj që ka qenë gabim teknik, nëse ka qenë gabim teknik të kisha sugjeruar që të përmirësohet kjo ose nëse si mban premtimet ose propozimet e juaja të cilat na keni dhënë, dhe propozimet që kanë qenë të asamblistëve të juaj, pra kërkoj që të vendoset te pika e dytë e pastaj të hedhet në votim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Faleminderit do ta jap përgjigjen, por dikush tjetër ka me diskutuar.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, Kryetar, drejtor, të nderuar asambleist të pranishëm, të dashur qytetar të Komunës së Shtimes. Sa i përket pikës Pyetje dhe Përgjigje mendoj që duhet me pas parasysh rolin ton të asambleistit dhe ajo kërkesë të realizohet, mirëpo ana tjetër, Kryesues nuk po shoh asnjëherë informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë, andaj kërkoj nga ana juaj që si pikë e rendit të ditës të futet edhe një informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje për Kryetarin e Komunës zotëri Aliun, përshëndetje për juve kolegë asambleistë të Kuvendit, përshëndetje për drejtorët dhe të gjithë qytetarët e Komunës. Kryesues te diskutimi për rendin e ditës pajtohna plotësisht me parafolësit që është një zotim i juaji, si dhe ka qenë një zotim i shefit të subjektit të Lidhjes Demokratike dhe një zotim i zotëri Seferit, që pika e rendit të ditës “Pyetje Përgjigje” të jetë e dyta. Kisha pas dëshirë që këtu para qytetarëve mos ta mashtrojmë njëri tjetrin, po flas konkretisht për Kadriun dhe Besnikun, jashtë paraqiteni si skifterë e këtu para Kryetarit të Komunës bëheni pula. Kisha pas qef me e mbajt premtimin ku qytetarëve ju premtojnë se kanë me punuar me ndershmëri e këtu ju ndodh e kundërta, prandaj “Pyetje Përgjigje” qysh janë zotuar ta qesin si pikë e dytë e rendit të ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, Po dua me u ndërlidh me parafolësin, është fakt që ne jemi zotuar që pika “Pyetje Përgjigje” të jetë pika e dytë e rendit të ditës, por jo si në të kaluarën që është hequr krejt nga rendi i ditës, asesi nuk lejoj as në të kaluarën as tani kjo pika ka me qenë pjesë e rendit të ditës, pak ka rëndësi a është pika e parë e dytë apo e fundit e rendit të ditës, me rëndësi është që do të jetë si pikë e rendit të ditës. Sa i përket pikave të rendit të ditës ne pajtohemi plotësisht me këtë rend dite nga ajo çka na është ardhur nga ju si Kryesues, ne duhet të vazhdojmë tutje të diskutojmë gjitha pikata e rendit të ditës.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, realisht sa i përket pikës “Pyetje Përgjigje” siç e dini në mbledhjen e parë unë qysh atëherë kam kërkuar që mos të jetë fare si pikë e rendit të ditës, duke marr parasysh gjitha pikat e rendit të ditës, pika “Pyetje Përgjigje” është më pakë e rëndësishme. Ndërsa sa i përket zotimit që unë kam dhënë, unë kam kërkuar që kjo pikë të jetë e dyta si pikë e rendit të ditës, unë jam zotuar që pika “Pyetje Përgjigje” do të jetë si pikë e rendit të ditës, dhe patjetër që duhet me qenë edhe jam që në vazhdimësi duhet me qenë. Pak e rëndësishme është se ku është si pikë e rendit të ditës, e rëndësishme është që drejtorët me u përgjigj në secilën pyetje, që janë bërë nga asamblistët. Sa i përket propozimit të Adelina Beqa për pikë shtesë të rendit të ditës “Informatë nga DSHMS-ja” realisht është një kërkesë shumë e arsyeshme me qenë, por jo në këtë mbledhje, për shkak se edhe nëse e fusim si pikë të rendit të ditës, s’mundemi me marrë informacion. Normalisht që një raport i tillë duhet të përgatitet nga drejtori kompetent, kështu që për seancën tjetër është mirë me qenë si pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ju kisha lut që mos të kalojmë në replika, sepse jemi tu fol vetëm për rendin e ditës, e replikat i vazhdojmë gjatë mbledhjes. Adelina ka dhënë një propozim, unë e kam propozimin. Gjatë shqyrtimit të pikave të rendit të ditës mundeni me replikuar por tash duhet me diskutuar për rendin e ditës. Pra Adelina ka dhënë një propozim, dhe do ta hedhi në votim. Dikush tjetër a ka me diskutuar rreth rendit të ditës.

z.Rrahman Jakupi; Të nderuar qytetarë të Komunës së Shtimes, të nderuar koleg. Desha të ndërlidhem rreth kërkesës së zonjës Beqa, me që edhe zotëri Emini u pajtuan që të jetë si pikë e

rendit të ditës në mbledhjen e radhës, propozoj që për mbledhjen e radhës sot të votohet që të jetë si pikë e rendit të ditës shtesë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Mua më duhet për hir të qytetarëve të jap sqarime, sepse mu lakua emri nga z.Rexhep Gashi, fillimisht nuk e kuptova për çka e patë fjalën, por pastaj duke i dëgjuar gjithë asambleistët e mora konfirmimin. Zotëri, Gashi thotë që keni folur në 2015 për një pikë të ndryshme, ndoshta e ke thanë gabim, edhe unë nuk e di që ne kemi diskutuar për këtë çështje. Sa i përket pikës “Pyetje Përgjigje”, shefi i grupit e dha arsyeën s’po dua me dhënë edhe një herë të njëjtën, se ne jemi një. “Pyetje Përgjigje” është në rendin e ditës dhe pak ka rëndësi a do të jetë e dyta apo e treta. Ka pika shumë më të rëndësishme që me i diskutuar sesa kjo. Unë fillimisht e hedhë në votim rendit e ditës ashtu siç ka ardhur, pastaj nëse nuk kalon e hedh në votim edhe me propozimin e Adelina Beqa.

z.Përparim Ramusa; të lutem një sqarim në emër të grupit. S’pe di sa e kuptove, jam i bindur që e ke kuptuar, është propozim për me hedhë në votim një pikë shtesë për mbledhjen e radhës, ke edhe akordimin e LDK-së kisha pas dëshirë me hedhë në votim pastaj me vazhduar, për mbledhjen e radhës pe kërkojmë jo për këtë mbledhje se e di që nuk bën me që drejtori nuk është prezent.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Zotëri Ramusa, rendi i ditës hidhet në votim ashtu siç vije prej Kryesuesit dhe Kryetarit, ashtu e thotë edhe Rregullorja e punës së Kuvendit. Shefi i grupit të LDK-së është dakorduar nëse përfaqësuesi i LDK-së është kundër rendit të ditës nuk e voton edhe vazhdojmë me propozimet.

z.Kadri Emini; Nuk e di qysh mundemi ligjërisht sot me votuar për një pikë që me fut në rend dite për mbledhjen radhës. Unë thash që propozimi Adelina Beqa është shumë i arsyeshëm, është mirë me qenë si pikë e rendit të ditës në seancën e radhës, te na vjen një raport i shkruar, sepse sinqerisht kemi nevojë me pa, por me votuar sot për një pikë të rendit të ditës për mbledhjen e radhës nuk pe shoh të arsyeshme. Vetëm llogaritni që nëse në seancën tjetër ajo pikë e rendit të ditës nuk vjen na do të jemi “për” dhe deklaroj publikisht që të jetë si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Vetëm diçka ne e kemi bërë një planë të punës dhe plani i punës i ka edhe informatat siç janë sot nga DKA dhe DPUKGGJ, secilën seancë ka informatë, nëse ka diçka që duhet me urgjencë me futë në rend dite unë pajtohem, por sot na nuk mundemi me marr informatë nga DSHMS-ja, atëherë po e hedhi në votim rendin e ditës, e pastaj flasim për secilën pikë të rendit të ditës.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për”, me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 31.01.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; S’po kam qare pa fol për procesverbal ka ndodhur komplet devijim i fjalive. Kryesues po ta lexoj çka ka shkruar “Sa me kujtohet Kryesues keni premtuar që kjo ka me qen pika e dytë, mbaje premtimin” as nuk ka shkruar për çka e kam pasur fjalën, këtu ka qenë tema për rend të ditës konkretisht për “Pyetje Përgjigje”, ka vazhduar prap “Kuvendi duhet të diskutoj edhe nëse ka pengesa ligjore, as ne nuk jemi me miratuar me pengesa ligjore” D.m.th këtu nuk ka kuptim, këtu ka qen fjala për kërkesën e Ramiz Kadriut e ngritur nga Hasan Avdyli për çështjen e Shtëpisë së Komunitetit, e ka devijuar. Kisha pas dëshirë Procesverbalit të vije me përmirësime, të dëgjohet stenogrami një herë pastaj të shkruhet, sepse se kam thënë kështu çka ka shkruar.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, sa i përket Procesverbalit, se edhe se paskemi Idajetin këtu a ka dal në pension a? Faktikisht edhe te diskutimet e mija ja ka huqur total prapë edhe nga Procesverbalit i muajit kaluar unë e kam jap sqarimin çka kam diskutuar edhe pse mi ka bart prapë të njëjtat, a ka diçka që nuk pi pëlqen atë, që e shoh në disa përgjigje tjera ka qenë shumë konkret. Te pika 1, prapë ma ka bërë të njëjtën sikur muajin e kaluar. Unë te pika 1 kur kam diskutuar për Procesverbalin kam thënë që shqetësim i jemi është që ja ka humb orientimin pyetjes prap e ka bërë të njëjtën. Unë nuk kam thënë qe kemi drejtori për buxhet të jemi të kjartë, procesmbajtës të drejtorit kam thënë kemi drejtori pa buxhet jo s’kemi drejtori për buxhet, nuk ka kuptim kjo. Pyetje, Kryetarit i kam bërë dhe

kam thënë në qoftë se e kemi të buxhetune. Pikërisht ka qenë fjala për drejtorin e Inovacionit, dhe në qoftë se e kemi të buxhetune në buxhet 2024 në cilin kod e kemi ma tregoni, kështu kam thënë. Te pika 9 te diskutimi te çështja, a e kemi pasur Draft-Programin Strategjik për ujërat, ja ka huqur total, pa kuptim si ka dhënë kuptim pyetjes që unë e di saktësisht çka kam pyet. Te çështja tjetër e kam ngreh shqetësimin te ky Draft Strategjik për ujërat, e kam diskutuar që çështja lumenjve sa është e rrezikuar dhe sa është e ndotur. Te pjesa kur kemi biseduar për rrjedhojën e burimeve, këtu ja ka huqur total. D.m.th për rrjedhojën e burimeve kam thënë, a janë të identifikuar sa burime ka në komunën tonë, a kemi arrit me i numëruar këto edhe mi nxjerrë numrat. Këtu e kam krejt ndryshe të shkruar. Kisha propozuar që ky Procesverbal të rregullohet dhe mos të na lihen pyetjet gjysmake, ku ja ka hup kuptimin secilës pyetje. Prapë te Mollopolci kam diskutuar, për 90% kam thënë që e kanë ujin me ramje të lirë. Nëse ndërmerret për mbrojtjen e burimeve, kam thënë si do të bëhet zgjidhja për fshatin Mollopolc, ku nuk ka ujë të pijshëm me këtë plan strategjik që nëse burimet e pjesës tonë ndalohen nga qytetarët që e kanë marr ujin me ramje të lirë, si do të bëhet zgjidhja. Këto kanë qenë pyetjet e mia si do të bëhet zgjidhja për këta qytetarë. Kështu që asnjë diskutim që kam diskutuar nuk ka shënuar. Unë nganjëherë po çuditna që Idajeti s'po besoj që e ka bërë Procesverbalin. Edhe një pyetje e kam diktafon a keni, a dëgjohet ai çka flet, se kështu me ja huq total është shumë absurde.

z.Rexhep Gashi; Me të vërtetë duke e njoftur punën dhe profesionalizmin e Idajetit jam befasuar. Ja nuk është ka e bënë punën si duhet, ja është ka na injoron. Te Procesverbali pikërisht te diskutimet e mia, çka është ma shqetësuese të "Pyetjet Përgjigjet" e ngritura. Ne kemi ngritur ç'do herë shqetësimet e qytetarëve, që janë të pakuptimta si pyetje që i kanë bërë në proces, kuptohet që përgjigje nuk kanë hiq. Unë pikërisht te një pyetje ju kam drejtuar Kryetarit, Kryetar çka është tu u punuar në ujësjellësin në Pejtërshticë, që në zgjedhje ju keni premtuar se do bëni zgjidhje qysh në vitin e parë, a do ta zgjidhni këtë problem. Ky pyetjes ju ka drejtuar kështu: Çka është puna me ujësjellësin, puna me ujësjellësin unë nuk e kam pyetur, e kam pyetur pikërisht ju kam drejtuar në cilën periudhë, cilin fshat ke investuar e që e ke premtuar. Ju kam drejtuar përsëri Kryetarit, Kryetar personalisht neve si votues te premtimin që e kemi pasur te ti, jeni zotuar që qysh në fillim të mandatit do të merreni me çështjen te ndërtesa e Fitores. A është inicur kjo çështje deri ku keni arritur kjo procedura lidhur me këtë çështje. Kjo pyetje nuk është e përfshirë, por edhe përgjigja e Kryetarit nuk mu ka dhënë. Për herë të dytë jam tu e bërë këtë pyetje, herën e parë e kam marr përgjigjen, herën e dytë nuk mu ka përgjigjur, as pyetja nuk është shkruar as përgjigjja. Mendoj se Idajeti nëse është tu u ngarkuar, nëse pe ngarkoni shumë me punë tjera, ta lironi që të punohet Procesverbali, ku shqetësimet e qytetarëve që na i bimë të jenë ashtu qysh i ngrismi.

z.Rrahman Jakupi; Ky procesverbal është skandaloz, përpos vërejtjeve që dhanë kolegët ky procesverbal nuk i plotëson kriteret me votuar po as me pru këtu. Nuk e di qysh po keni vullnet, ose qysh po keni arsye që u bënë që dy vjet e disa e që nuk ke arrit me zgjidh këtë çështje. S'di a e lexoni ju a jo, nëse dikush e lexon këtë Procesverbal ka me ja dhënë njësh, për hir të qytetarëve ky Procesverbal nuk duhet kështu të publikohet në faqe të Komunës, për ndryshe nëse publikohet unë do të ndërmarr hapa në aspektin ligjor me kontestuar. Kushdo që e ka shkruar përveç që nuk ka ditë me shkruar, gabime gjuhësore ka të tmerrshme gjithandej, kështu që Kryesues kërkojë nga ti ta iniconi këtë çështje, të përmirësoni Procesverbalin, siç e përmendi z.Mujota ekziston stenogrami, ekziston inçizimi në veb të Komunës. Ata që tentojnë me shkruar, ose që donë me shkruar duhet me dëgjuar aty, e jo vetëm me shkruar sipas qejfit edhe dëshirës që ata kanë mi ndërruar diskutimet tona, sipas qejfit tyre. Kështu që Kryesues kërkoj nga ti ta merreni seriozisht këtë çështje, për ndryshe ne në çdo mbledhje me rrok këtë temë, mendoj se është e pa arsyeshme, e me diskutuar për Procesverbal e prapë me ardhur me vërejtje dhe këto gabime gjuhësore.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Nuk kemi të paraqitur tjetër për diskutim. Atëherë procesverbali ka këto probleme për të cilat asamblistët i ngritën, unë kisha propozuar që ky procesverbal të kalojë dhe të rishikohet do të thotë me ndryshime. Dhe unë sinqerisht do të kërkojë nga Sekretariati që të shihet mirë. Por një gjë duhet ta thamë që sot po më pëlqen se si po diskutohet dhe po dëgjohet njëri tjetrin, ku edhe procesmbajtësi e ka ma të lehtë me marrë ashtu siç thuhet prej secilit asamblistë. Disa seanca po ka shumë komunikim mes vete dhe është shumë e padrejtë me i bërë presion

Procesmbajtësit se nuk mundesh me dëgjuar se çka thotë saktë, kështu që po e hedhim në votim këtë procesverbal me ndryshimet apo ma mirë me thënë me propozimet apo vërejtjet që u dhanë nga kolegët asamblistë, e që procesverbali të përmirësohet dhe të sjellët prapë në sallën e Kuvendit, në seancën tjetër

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota “Për”, me 2 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”, miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 31.01.2024.**

Pika 2

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, (pas diskutimit Publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Ne kemi edhe rekomandimin e Komitetit për Politik dhe Financa (lexoi rekomandimin e Komitetit). Dhe këto rekomandime i kemi futur në këtë Rregullore, dhe besoj që pasi që zonja Kimete të jap disa sqarime të shkurta ta hudhim në votim dhe të kalojmë si pikë, sepse e kemi diskutuar gjerë e gjatë edhe me KPF-në dhe gjitha ndryshimet që kanë ardhur nga diskutimet publike. Zonja Kimete fjala për juve.

z.Kimete Ukaj, ZKF; Përshëndetje, kjo pikë e rendit të ditës është Rregullorja për Taksa dhe Tarifa për vitin 2024. Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 4.2 pika (g) Të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimit të Akteve të Komunës; Statusit të Komunës së Shtimes 01Nr06/1636 datë 03.09.2008; Si dhe në bazë të Kërkesës së Ministrisë për Arsim, shkencë dhe teknologji Nr.06-1810 të datës 24.03.2023 për Rishqyrtimin e Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha. Zyra e Kryetarit propozon Draft-Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024. po e sjellim këtë rregullore për miratim. (Lexoi dokumentin).

z.Përparim Ramusa; Ashtu siç u dakorduar në KPF, propozimit, për të burgosurit politik ja kemi shtuar edhe dy propozime të reja si Komitet, që nga taksa të lirohen edhe familjet e të burgosurve politik, dhe familjet e invalidëve të UÇK-së. Të lirohen edhe te taksat por edhe te aktivitet kulturore, ashtu siç jemi dakorduar edhe në KPF.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Atëherë kërkojë falje për pak vonës, mu deshtë me u konsultuar me Kryetarin, nëse nuk ka diskutime tjera e hedhim në votim në bazë edhe të rekomandimit të KPF-së, që jemi pajtuar unanimitisht të gjitha subjektet.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, e falënderoj zonjën Ferati për informatën. Kjo rregullore ka qenë në diskutim publik, ku janë dhënë edhe propozimet konkrete, e kemi edhe rekomandimin KPF-së, për lirimin nga taksa për regjistrim të veturave të familjeve të ish-burgosurve politik. Ky Draft i plotëson kushtet ligjore, ku kërkesa e grupit tonë është të bëhet trajtimi real i tatimit në pronë. Ne si grup LDK-AKR do ta votojmë këtë Rregullore për Taksa Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, në mënyrë që të kemi stabilitet financiar për vitin e ardhshëm.

znj.Zenije Veliu; Përshëndetje, Mendoj se kjo Rregullore për Taksa Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, është në rregull, propozojmë që të përfitojnë edhe familjet e ish-burgosurve politik si dhe familjarë të invalidëve të luftës sipas Rekomandimit të KPF-së, mandej edhe te neni 11 paragrafi 11 pika 3 gjatë pushimeve verore në Çerdhe tarifa të realizohet vetëm gjysma e pagesës. Kështu që mendojmë se kjo rregullore është e harmonizuar me propozimet e dala nga diskutimi publik dhe ekzekutivi i Komunës si dhe rekomandimet e dala nga KPF. Kështu që ne si grup parlamentar e mbështesim këtë Draft Rregullore për Taksa Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024.

*** Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimitisht miratoi Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024.**

Pika 3

Informatë për zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Zonja Kimete fjala për juve.

z.Kimete Ukaj, ZKF; Bazuar në Rregulloren e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit të i nxjerrë nga Ligji Nr.05/L-055, neni 14 Plani i veprimit dhe njoftimi periodik lidhur me

rrjedhën e zbatimit të tij ku thuhet se pas hartimit të planit të veprimit entiteti i audituar i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Në bazë të ligjit për rekomandimet e Auditimit, dy herë në vit duhet të sjellim këtë informata pas ardhjes së raportit nga Zyra Kombëtare e Auditimit e kemi obligim ligjor ta sjellim në Kuvend, siç dihet kanë qenë 12 rekomandime 6 kanë qenë të vjetra dhe 6 kanë qenë të reja (lexoi raportin lidhur me rekomandimet dhe plotësimin e tyre si dhe cilat janë në proces) dua me ju njoftu që kjo vjen vetëm si informatë dhe nuk duhet të votohet.

z.Muhamet Ademaj; E falënderoj zonjën Ferati për këtë informatë, sa i përket raportit të auditorit, nëse shikojmë rekomandimet nga viti 2022 janë 12 rekomandime janë zbatuar 9, pjesërisht janë të zbatuara 3, të pa zbatuara nuk kemi. Sipas k'iti raporti shohim se te rekomandimet e auditorit nuk kemi të bëjmë me keq menaxhim, por rekomandimet janë dhënë si ndihmesë në realizimin e punëve të ekzekutivit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Nëse nuk kemi tjetër për të diskutuar pasi që kjo është informatë dhe nuk votohet, vazhdojmë me pikën tjetër.

Pika 4

Prop-Vendim për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Prapë po ja kalojmë fjalën Zonjes Kimete Ukaj.

z.Kimete Ukaj, ZKF; Ky propozim vjen duke u bazuar në neni 27 të Ligjit me Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, si dhe Ligji Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore e Republikës së Kosovës për vitin 2023, neni 30, të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal 2023 skadojnë në mesnatën e 31 dhjetorit 2023, me përjashtim ndarjeve buxhetore të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të komunave, apo të ndonjë Organizate Buxhetore tjetër të lejuara me këtë ligj të cilat barten në vitin vijues. Propozimet janë të përshkruara në formë tabelare sipas kufizimeve kontabël/financiarë buxhetor. Kodi Organizatë Buxhetore, Kodin e projektit, si dhe kufizim kryesor Kodin ekonomik të shpenzimit në programe të cilat nuk janë përmbushur në vitin 2023 dhe në projektet e miratuara me buxhet për vitin 2024 (jo projekte të reja) si në tabelat në vazhdim. Në bazë të propozimit për Ndarjen e të Hyrave të Bartura nga viti 2023 në vitin 2024 kemi bërë ndryshimin (rritje) në strukturën e kategorive të shpenzimeve kemi rritur kategorinë e Mallra dhe Shpenzimeve për 356.243.57 euro, kategoria e subvencioneve dhe transfereve e rritur për 109.024.14 dhe për shpenzimet kapitale nuk kemi rritje për mbulimin e aktiviteteve të planifikuara sipas drejtorisë ku janë ato më të nevojshme pasi kemi pasur tejkalim të kufirit të hyrave vetanake për 448.923.35 euro gjatë vitit 2023, të hyrat e pa shpenzuara të vitit 2023 (fondi 21) janë 100.738.18 euro, ndërsa të pa shpenzuara të hyrat e vitit 2022 (fondi 22) janë 79.091.53 euro, ku në total shuma për bartje është 328.753.06 euro. Këto të hyra janë planifikuar të barten në kategoritë ekonomike Mallra dhe Shërbime shuma prej 378.842.06 euro, në ato nën programe të cekura në kërkesë për mbulimin e nevojave të tyre dhe obligimeve si pasojë e rritjes së çmimeve (blerja e druve, mirëmbajtja e objekteve, furnizime të ndryshme, blerja e barnave etj.). Në kategorinë ekonomike subvencionet dhe transfere shuma 149.911 euro është planifikuar në nënprogramin Zhvillim dhe Inspektim Bujqësor për mbulimin e shpenzimeve të fermerëve si dhe nënprogramin Shërbimet Kulturore për financimin e klubeve sportive ku kërkesat e tyre kanë qenë shumë më të larta se shuma e ndarë me buxhet, të Shërbime Sociale, Administratë, Shëndetësi për pagesën e nënave lehona. Në kategorinë e shpenzimeve kapitale shuma është 100.000.00 euro e planifikuar në projektet e vitit 2023 ku ende nuk i kemi lidhur kontratat, pra projektet gjenden në fazën e tenderimit.

z.Rexhep Gashi; Falënderojmë zyrtaren kryesore financiare zonjën Kimete që na e bëri një elaborim. Janë për tu përshëndetur të hyrat që janë bartë gjatë këti viti. Dua të lidhem me këto bartje, Zyrtare kryesore financiare duke ditur përvojën tuaj në këtë punë, sikur e dimë edhe te bartja e të hyrave më herët ka ndodhur në investime kapitale, jo mallra dhe shërbime, ju personalisht keni ngrit shqetësim lidhur me propozimet e mia që kam bërë. Unë nuk pashë asnjë shumë të bartur që do të shkoj për investime kapitale. Te planifikimi duhet të falënderojmë të gjithë drejtorët e shkollave që kanë bërë një mirë planifikim të tillë dhe dalin sa ma të saktë, duke parë përvojën e tyre. Mirëmbajtja

e objekteve, sepse edhe mirëmbajtja e objekteve e ka një planifikim, furnizimet e ndryshme, çka, cilat kategori do të përfshihen, te ndryshmet është bajagi i gjerë ky term. Blerja e barnave po e kuptoj. **Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Zonja Kimete a ki diçka me thanë, apo po i merr kështu pyetjet me radhë.

z.Kimete Ukaj, ZKF; Po i marr me radhë pastaj përgjigjem.

znj.Adelina Beqaj; Sa i përket këtyre të barturave, drejtori pa pikë të buxhetit, 628 mijë euro edhe mos me pas asnjë informacion nga kjo drejtori. Në anën tjetër për derisa ekzekutivi e ka bërë ndarjen e mjeteve, unë nuk po shoh këtu drejtor a drejtoresh që kanë guxim me dal me i mbrojtur këto mjete që i kanë kërkuar, andaj Kryesues tu kisha lut merre një kohë pauzë deri sa të na vinë krejt drejtorët edhe të na e arsyetojnë çka kanë me bërë me këto mjete, mua më kujtohet fortë mirë, Vetëvendosja kur kërkonin specifikacion të projekteve dhe specifikim të mjete, ku jeni ju konkretisht tani. Tu kisha lut Kryesues me mbajt Kryetarin nën kontroll kur po diskutojmë. Je Kryetar Komune, je intelektual mbaje pak qëndrimin tan si të ka hije.

z.Përparim Ramusa; Sinqerisht te kjo kërkesa për bartje është shqetësuese siç e tha parafolësi, jemi tu folur për të hyrat vetanake prej 180 mijë euro që kanë tepruar, edhe një pjesë tjetër që ka kaluar parashikimin diku afër 83 mijë euro, është shqetësuese se provoja na e ka imponuar që te të hyrat vetanake ti dërgojmë në investime kapitale. Prej 630 mijë eurove vetëm 100 mijë euro i keni planifikuar për investime kapitale a këndej rrush e kumbulla, si mundet me kanë kjo që prej 630 mijë euro vetëm 100 mijë euro për investime kapitale do te thotë i keni 356 mijë mallra shërbime kurse 100 mijë te investimet. Dua mu lidh edhe pak, qysh munden me tepruar 180 mijë euro kemi në Arsim pastaj katastrofa natyrore në bujqësi etj. A nuk keni pas ku me i alokuar a? Tani kërkonti prej Kuvendit 628 mijë euro ti bartni në mallra dhe shërbime, ku edhe kjo shumë për investime kapitale thoni janë bartur në projekte që ende janë në fazën e tenderimit, qysh jua kap logjika juve që keni hapur fazën e tenderimit kurse ende si keni paret? Ku keni qenë të sigurt që ju kalojnë këto bartje. Bëhuni pak ma serioz se faza e tenderimit, ku qiten projektet e paret s'janë si mundet me kanë kjo. Po ju bëjë pyetje nëse këto 100 mijë euro nuk ju kalojnë ku i merrni paret ju. Presim përgjigje nga ZKF për këto shqetësime tonat.

z.Reshat Mujota; Me të vërtetë bartja e të hyrave prej vitit 2023 në vitin 2024 është pak befasuese në disa segmente. Këtu ma shumë e kam parë këtë bartje si dëshirë të drejtorëve, bartmi mua kaq bartmi mu kaq, kërkesa pa plan nuk e di se çka janë tu vepruar. Çështja tjetër u hap Drejtorja e Bujqësisë dhe aty nuk u menaxhua mirë buxheti tani qitja edhe nja 36 mijë euro. Prapë te Drejtorja Bujqësisë ka munguar, mirë është mu përkrah bujqësia, por këto janë pare të qytetarëve, domosdo duhet të kthehen tek qytetarët. Te bartja e 100 mijë euro te investimet kapitale janë pak, shumë pak janë. Ma mirë kishte me qenë që kjo bartje të diskutohet në Kuvend dhe secili asambleistë ta jep kontributin e vetë, sesa ekzekutivi ti bjen. Kjo a din qysh pi bjen, unë ti bie qashtu e ti votomi, kjo i bjen udhës me votuar secili asambleistë, kjo i bjen unë ti bie qysh dua, e ti ke me ngrit dorën mi votuar. Kështu nuk bartet buxheti, po buxheti bartet në ato sektorë të cilat ka nevojë më së shumti, nuk kemi me i përfunduar projektet te investimet kapitale, ka projekte që kanë mbetur në gjysmë, ka punë shtesë. Pse nëpër gjitha këto dikastere që janë, te veturat pajtoj me pas blerje me u ble veturat, sepse e di që është anuluar kontrata për qiramarrje me këto veturat e më hershme, dhe këto vetura ju duhen në shërbim Komunës por mi investuar 80 mijë euro edhe pse kanë qenë të planifikuara 80 e diçka mijë, nuk pe shoh të arsyeshme p.sh. mu ble 5 vetura e diçka tjetër ta lëmë mangu. Te çështja e Arsimit pak drejtoresha u dashtë me qenë më këmbëngulëse sepse ka me pas sfida në Arsim, sidomos në projektet e shkollave, është dashur të ketë bartje pakë më shumë, është tu më befasuar drejtoresha e DKA-se që nuk ka insistuar me pas më shumë nga këto të bartura me pas pare më shumë. Kështu që te këto në Arsim me pas mundësi, tani s'pe di sa është mundësia me vendos Kuvendi për sektorë për të cilat na nevoiten më shumë, a di çka vota e përcakton edhe ndarjen por mënyra nuk po më del reale, ose për me dëshmuar secili që ka kërkuar këtë bartje buxhetore duhet drejtorët të jenë prezent të na sqarojnë çka kanë me bërë me këto mjete, apo paraprakisht të na e dorëzojnë si material, ku është destinimi, çka janë veprimet, cili është plani i punës tyre, na si Kuvend kishim mundur me votuar, për ndryshe unë këtë bartje buxhetore nuk po e shoh të arsyeshme prandaj unë nuk do ta votoj, ndoshta e kisha votuar nëse në këtë bartje me u kalkuluar nëpër sektorë

po. Për dallim nga Adelina Beqa që kërkojë, te drejtoria e Inovacionit nuk u kalkulua askund, na në projekte s'mundemi me qit pare. Kjo drejtori sot na e dëshmon se nuk ka buxhet. E kam bërë ket pyetje më herët e kam kërkuar kodin buxhetor por nuk ma kanë jap përgjigjen, nuk ma kanë sqaruar. Kështu që unë për momentin te kjo bartje nëse epet mundësia për mi bartë të hyrat ende në investime kapitale ok e kisha votuar sepse kam edhe kërkesa edhe të miat për investime kapitale, që e di që në disa projekte në disa fshatra nuk ka buxhet të mjaftueshëm dhe keni me parë kur të ja filloni punës që keni me lënë në gjysmë.

znj. Zenije Veliu; Lidhur me propozimin për bartjen e të hyrave prej vitit 2023 në vitin 2024 vërejmë që të hyrat e pa shpenzuara prej vitit 2023 janë 100.738.18 euro dhe nga viti 2022 janë: 79.091.53 euro, këtyre shumave jua shtojmë edhe shifrën 448.923 euro shuma e cila është grumbulluar gjatë janar-dhjetor 2023 te të hyrat vetanake, ku ne e dimë se në vitin e kaluar kemi pasur tejkalim të kufirit të hyrave, dhe gjithandej do të barten 628.753 euro. Në raportin që na është sjellë nga ZKFF-ja duke na arsyetuar se kërkesat e tyre ishin më se të arsyeshme. Te Drejtoria e Shërbimeve Publike vërejmë se kjo ndarje, për menaxhimin e katastrofave natyrore, po shohim se ndarja është e domosdoshme për këto mjete, duke pasur parasysh se kjo drejtori ka të bëjë drejtpërdrejt me mërqinjën e qytetarëve. Mandej te zjarrfikësit edhe këtu mendoj se ishin më se të nevojshme duke pasur parasysh problematikat që përballet, po ashtu duke pasur parasysh se këto buxhetohen nga Kuvendi por menaxhohen nga linja përkatëse. Kështu që unë kërkojë nga ekzekutivi që të komunikoj me linjën përkatëse që bashkërisht ta hartojnë një rregullore me të cilën do të mund të angazhohen gjatë periudhës verore si personel i përkohshëm, kuptohet me pages, deri sa të kompletohen me staf të nevojshëm, sepse në bazën e strukturës këtu nevojiten 18 zjarrfikës e aktualisht janë vetëm 7 zjarrfikës, ku disa prej tyre kanë edhe probleme shëndetësore.

z. Kadri Emini; Të njëjtën pikë e diskutuam edhe ne Komitetin për Politik dhe Financa dhe u tha që sigurisht ka një dakordim në mes dikastereve të Komunës, përkatësisht mes drejtorëve sa i përket propozimit për ndarjen e këtij buxheti. Për derisa ne në këtë Kuvend nuk kemi ndonjë pakënaqësi apo kërkesë të një drejtorie për një ndarje më të madhe apo ma të vogël, kjo nënkupton që ka dakordancë në mes të dikastereve. Konsideroj se është në harmoni të plotë ndarja, nuk është e ndarë vetëm në njërin drejtori, por është e ndarë në secilin dikaster sipas prioriteteve që kanë. Sa i përket investimeve kapitale jemi të vetëdijshëm se edhe dhjetë herë më shumë më pas qenë, kishte me qenë mirë, por sinqerisht edhe dikasteret tjera kanë nevojë për mjete. E përmendën çështjen e investimit kapital 80 mijë euro për blerje të veturave, aktualisht Komuna ka nevoja të jashtëzakonshme me i ble veturat, fatkeqësisht nuk janë blerë më herët, sepse punët ne teren nuk munden zyrtaret komunal mi krye në këmbë, siç po ndodh tani mjetet personale po i përdorin zyrtaret për inspektimet në teren. Mendoj që propozimi është i mirë, kështu duhet të votohet.

z. Përparim Ramusa; Pak po më befason diskutimi i Kadriut, jemi tu diskutuar për 630 mijë euro taksa të qytetarëve Shtimjan që ekzekutivi ua ka marr, e del Kadriu thotë janë marr vesh drejtorët në mes veti, nuk jena ardhur këtu na me u marr vesh në mes veti, ka sa pare pi marrim këto janë pare të qytetarëve, paskan qit short në zyre të Kryetarit, kjo nuk shkon kështu. Qysh mundemi me përkrahë një bartje të tillë kur prej 630 mijë eurove ti kanë qit vetëm 100 mijë te investimet kapitale, a keni parasysh që fshatrat malore ende ujësjellës nuk kanë, ende ujë nuk kanë e ti thua janë marrë vesh drejtorët mi nda për Mallra dhe Shërbime. Duheni mu paraqit pak më serioz se jemi tu i përfaqësuar qytetarët e Komunës. Po flas në emër tim që këto bartje 630 mijë euro janë ekskluzivisht taksa të qytetarëve. Nuk mundem me votuar, sepse prej 630 mijë euro vetëm 100 mijë i keni alokuar te investimet kapitale, tjerat nuk janë për investime kapitale. Ju kisha apeluar edhe kolegëve që këtë formë të bartjes mos ta kalojë. Më pëlqejë diskutimi i Reshatit se kemi projekte që nuk janë filluar, të diskutojmë për projekte veç e veç.

z. Kadri Emini; Vetëm një sqarim investim kapital do të thotë çdo investim, secili mjet që bartet sot ka mu bart për qytetarët, asnjë pare nuk ka me marr drejtori për veti, te bujqësia bile pakë janë 30 mijë euro, nuk janë pare të mjaftueshme për investime në bujqësi. Pastaj Përparim mos i jep kaheje tjetër, jo rrush e kumbulla, jo ashtu se të gjitha janë investime për qytetarët, edhe mallra dhe shërbime, sepse realisht pa mallra dhe shërbime nuk mundet me funksionuar. Unë pe shoh vazhdimisht e kontestoni blerjen e veturave, duhet mi pas Komuna veturat, nuk është vetura lluks

vetura është nevojë, ju i keni pasur edhe prap i keni marr me qira, duhet mi pas veturat edhe kur të amortizohen duhet me i blerë tjerat. Nevoja është e domosdoshme për këto, blerjen e këtyre veturave, nevoja është e domosdoshme në secilin dikaster, jo vetëm në investime kapitale një e dyta mos të harrojmë kemi projektin e lumit është investim kapital direkt nga Qeveria.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Zotëri Emini shihen investimet kapitale në Republikën e Kosovës mundet mi pa çdo kush. Tu kisha lutur zonja Beqa, ju kisha lutur të gjithëve që të përmbaheni.

z.Asllan Beqaj; Përshëndetje, sa i përket propozimit për ndarjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024, duke e ditur në të kaluarën qysh janë bërë ndarjet, tani është bërë ndarja duke u bazuar në nevojat e qytetarëve, kështu që mendoj se është ndarja më e mirë e mundshme. Kërkesat e drejtorive asnjë, nuk e pash që janë për rrush e kumbulla, të gjitha janë kërkesa që kanë prioritet dhe duhet mu miratuar dhe me u përkrahur prej secilit asambleistë. Nuk e di qysh po mundeni me marr fjalën e me thënë që nuk është shpenzuar buxheti kur na kemi pasur një buxhet të shpenzuar prej 96 % vitin e kaluar. Vitin e kaluar më kujtohet shumë mirë te bartja e të hyrave bajagi shumë është vonuar kjo pjesa e votimit, deri në vjeshtë nëse nuk gabojë. U mundu me u bllokuar me çdo kusht që mos me u përkrah projektet dhe mos me u vazhduar por besoj që në këtë vit nuk e keni atë mundësi, sepse bartja e të hyrave është bërë në mënyrën më të mirë të mundshme. Drejtorët i kanë dërguar kërkesat sipas kërkesave të qytetarëve dhe nevojave për projekte. Kështu që unë e inkurajoj secilin asambleistë që ta votojë këtë propozim, sepse është ndarja më korrekte e të hyrave që ka ndodhur deri më tani.

z.Besnik Seferi; po dua me u lidh që u tha se ne si LVV-ë kemi kërkuar gjithmonë specifikim të projekteve po pajtohem me parafolësit që nuk ka specifikim atëherë duhet me dit se i kemi drejtorët që munden me u përgjigjur për projektet se qysh ka do të shkojnë. Sa i përket Drejtorisë së Inovacionit sigurisht e shohim që ka ndodhur një gabim teknik, megjithatë unë e di që kjo drejtori do të ketë një projekt në vlerë prej 16200 euro nëse nuk gabohem me “Flutura Academy” ku Kryetari e ka postuar në facebook personal e cila do të jetë projekt që do të përfitojnë nxënësit nga klasa 3 deri në klasën e 12, dhe do të kenë mundësin të ndjekin kurse të gjuhëve të huaja, programim, robotik, dizajn grafik, etj. Këtu 60 nxënës do të subvencionohen nga Komuna e Shtimes dhe 90 të tjerë nga “Flutura Academy” i cili do të jetë me një bashkëpunim të tillë i cili do të rris kapacitetet për zhvillimin e shumë çka tjetër për këta nxënës. Unë jam i gëzueshëm sot, meqenëse po flasim për katastrofat natyrore e ku DSHP-ja do ta ketë një buxhet i cili ndoshta për herë të parë është, e është dashur të parashihet edhe më herët. Mendoj që është bërë një ndarje shumë e drejtë, duke pasur parasysh katastrofat e më hershme, në kuadër të kësaj ndarje do të jetë mundësia e mirëmbajtjes së trotuareve, mirëmbajtja e të gjitha rrugëve e në veçanti në kuadër të saj do të jetë edhe mirëmbajtja e varrezave në qytetin e Shtimes dhe në fshatra. Kjo është një diçka që duhet me u përgëzuar, dhe një ndarje e tillë gjithsesi edhe duhet të aprovohet. Sa i përket ndarjeve të tjera, unë mendoj që si i tillë si dokument si ndarje duhet të aprovohet. Unë e thash nëse ka nevojë për sqarime mundet nga secila drejtori me jap sqarime. Unë e di që edhe Arsimit i kemi hyrë në hak, tu e dit që Arsimi është një diçka e gjerë si drejtori, por sigurisht që në të ardhmen do të ndajmë më shumë buxhet te Arsimi, shpresoj se do të na epet mundësia me rritjen e buxhetit nga viti në vit apo të hyrat. Dihet se sivjet kemi shumë renovime të shkollave e për të cilat ndoshta është pak që të bëhet si është planifikuar, por një ndarjeje e tillë ka qen dashtë edhe nga drejtorja e Arsimit. Ne si grup parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje jemi “për” që të aprovohet ky propozim si i tillë dhe këto të hyra të jenë në kontribut në të mirë të gjithë qytetarëve të Komunës.

z.Reshat Mujota; Kryesues, faktikisht nuk pata me replikuar por debati po të nxit me replikuar. Po çuditëm para vetes kemi një propozim për ndarjen e të hyrave, dalim diskutojmë diçka tjetër duke u nis te drejtoritë që kjo bëhet, a buxhet nuk ka hiç. Unë po çuditëm kur thotë parafolësi, Drejtorisë së Arsimit i kemi hy në hak, do me thënë ky është pjesëmarrës i ndarjes buxhetore. Nuk i hyn në hak Drejtorisë së Arsimit ti kontribuon sot, ti mos i hyn në hak kontribuo në Arsim. Dakordimi, këtu e thash edhe më herët gjitha këto ndarje janë bërë, këtu po shihet që koalicioni qeverisës, ja bëjnë bartmi kaq në drejtorin time në Vetëvendosje, bartmi kaq në drejtorit mija. Faktikisht a e din çka bëhet me këto bartje këtu, shtrohen asfalte nëpër oborre private, kështu përdoren paret e taksa paguesve tanë që nuk e dinë, shtronë oborre me asfalt edhe i përdorni qeto pare. Unë kisha kërkuar

që çështja të blerja e veturave le të jetë vlera 80 mijë euro, ka nevojë Komuna të jetë, mos të diskutohet kjo, po te Arsimit ta bartim edhe një shumë, ku e kemi rregullimin e oborreve të shkollave, sallave të shkollave, kemi shkolla që janë të pa rrethuara janë të demoluara, hajde të bartim mjete te Arsimit, të bartim se e kemi mundësinë, kemi mundësinë me bart edhe shuma te investimet kapitale. Kisha propozuar që të paktën te Arsimit, si propozim i jemi le të jetë pikërisht, që të barten një shumë në vlerën prej 20 mijë euro shtesë. Secilin kod ta shohim e tash ta analizoj, edhe pse e kam analizuar përafërsisht, por mundem tani shumë shpejtë mundemi me hekë nga secili kod kapak edhe me bart në kodin e Arsimit.

z.Lumni Amrush; Përsëritet, po shoh, pak janë mbi 600 mijë euro të alokohen kështu në projekte aq të vogla e të cilat nuk e prekin mirëqenien e qytetarit, në kuptimin që ka nevojë për projekte pak më të mëdha. Ka qenë premtim i Kryetarit që nëse nuk mundem në vitin e parë, qysh në vitin e dytë fshatrat nga vije unë Pjetërshticë, Zborcë e Carralevë do të kenë ujësjellës, është dashtë të planifikohet edhe për atë pjesë një shumë që të zgjidhen këto probleme. Me qenë se u përmend Arsimit për mos me i hy në hak, po mendoj jeni hy ne vitin e tret të qeverisjes. Fshati Pjetërshticë e gëzon një shkollë të re, po punohet edhe në palestër, janë projekte që kanë vazhduar, ku për shkak të këtyre punimeve janë dëmtuar pjesa e rrethojave të oborrit të shkollës, dhe ka një nevojë urgjente, është mirë të mendohet edhe për atë pjesë. Sa i përket DSHMS-së mungesa e drejtorit të shëndetësisë edhe këtu në Kuvend edhe në KPF edhe këtu në takimet e juaja po shihet që ky nuk ka mundur shumë me prezantuar, po shihet sa ka ndryshim janë një shumë afër 5 mijë e diku afër 4 mijë euro, ku hajt qeto s'po dimë ku i qojmë, e hajt po ja lamë aty të shëndetësisë, s'di kush është ai drejtor. Kështu që është mirë pak me menduar për projekte më madhore duke pasur përsysh edhe rritjen që ka ndodhur në vitin e kaluar edhe ato te mbetura nga vitet e më hershme, mendoj këto të hyra ish kanë dashtë mi nda në mënyr më të mirë.

z.Besnik Seferi; Po dua me u ndërlidh pak me parafolësit, meqenëse u tha paska marr pjesë në këtë ndarje, mua thjesht më ka interesuar ndarja e këtyre të hyrave që është duke u bërë dhe ku do të shkojnë, u tha është mirë në drejtori të Arsimit, edhe sikur të bartet krejt ky buxhet në Arsim ende nuk mjafton, por kjo situat na ka pru në këtë gjendje, e kjo situatë nuk është rasisht që është krijuar prej atyre që kanë qenë më herët në pushtet, këte duhet me ditë secili.

z.Përparim Ramusa; Përralla janë këto.

z.Besnik Seferi; Qytetarët e dinë fort mirë, assesi nuk po dua me u kyç në atë se a po tregoj përralla a jo, thjeshtë po tregoj një realitet. Shumë mirë e thash që edhe ky 628 mijë euro, sikur të ndahet për Drejtorin e Arsimit është i pa mundshëm për me i përfunduar gjitha projektet që janë paraparë. Për herë të parë në Komunën e Shtimes është bërë një investim në projektet e investimeve kapitale ku në bazë të këtyre investimeve kapitale do të ketë renovime, ndërtimi i Çerdheve, do të jetë renovimi i shkollave e kështu me radhë. Unë e di që diskutimi im për kolegët e mi opozitar është i pa pranueshëm por megjithat unë mendojë, si e tillë ndarja e këtyre të hyrave është në përputhshmëri me planifikimin dhe investimet që janë duke u bërë dhe kanë me u bërë dhe të cilat kanë me qenë në të mirën e gjithë qytetarëve të Komunës së Shtimes.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Zonja Beqa ju lutem jeni në seancë të Kuvendit, mbani qetësinë, nëse keni diçka personale mund ta lironi sallën dhe dilni në korridor.

z.Lumni Amrush; Kryesues, unë e mora fjalën mbase Besniku foli për 630 mijë euro, kur diskutova e pata ndërmend me përmend emrin Besnikut, që tha 630 mijë euro janë pak me i nda për Arsim, pra nëse i ka mbet edhe naj projekt me e përmend për me bë ndonjë status apo ndonjë video e me postuar në Facebook e pastaj me marr ndonjë llajk, gjithashtu edhe për zonjën Velu që po flet atje, merreni fjalën e mandej e postoni në facebook e merrni llajka.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ju kisha lutur të flasim për pikën e rendit të ditës.

z.Besnik Seferi; Kryesues a po e shef që kur nuk kanë ku kapen i përmendin llajkat, shumë mirë që po i përcjellshi, po më vjen keq që s'po i bejka llajka bile. Është problemi që fatmirësisht kemi çka prezantojmë. A di qysh është kjo punë sikur t'ju biesh pak në binar këtyre, ma i miri je për ta, nganjëherë edhe unë i kritikoj drejtorët e gjith mandj thonë a ti shumë i mirë je, e s'jam i mirë kur foli kundra tyre, nganjëherë ka edhe shumë arsyeje me fol, mosni koleg, këtu nuk përfaqësoj askënd,

këtu e përfaqësoj qytetarin e Komunës që ma ka dhënë besimin, e fundit ky buxhet ka me u investuar për të gjithë qytetarët e Komunës së Shtimes

z.Rexhep Gashi; Unë qe disa herë ju kam dhënë vrejte duhet të mbajmë një disiplinë në Kuvend. Nganjëherë mendoj që nuk janë përralla këto, se nganjëherë edhe mua mi dërgojnë do video, kjo është hipokrizi nuk po lakoj emra i dinë ata të cilët mi dërgojnë ato video, dhe me të cilat e bëjnë një populizëm në opinion publik, unë mendoj si asambleist duhet të flasim për rendin e ditës, Menaxhimi katastrofave një asambleistë që flet për herë të parë, nuk mund të kemi alokim të mjeteve pa kod. Edhe qeverisja e kaluar e ka pasur ket kod të projekteve të menaxhimit të katastrofave natyrore. Mendoj se edhe drejtoresha e Inovacionit duhet të na jep sqarim, çka ka menduar drejtoresha e dimë që nuk kanë buxhet, por duhet të dimë një buxhet ku i marrim parat. Çka ka marr masa në Shkollën Profesionale, drejtoresh nëse ki mundësi ma jep një përgjigje sa klasë janë të bllokuara, pse janë të bllokuara ato, çka ka në ato klasë që gjithmonë janë të mbyllura, ku edhe tualetet janë të bllokuara. Unë mendoj që kjo drejtori duhet me na jap një sqarim pikërisht që ka kërkuar në këto alokimet. Drejtorja e Inovacionit sa zyrtar i ka, sipas koeficientit të një sistematizimi kjo e ka koeficientin 7.9 që pi bien mbi 10 mijë euro në vit, nëse e ka zyrtarin e dytë e ka 9500 euro, në qoftë se e ka edhe zyrtarin e tretë, e ka edhe një 7392 euro, nëse e ka të katërtin 6482 euro që gjithsejtë bëjnë 33046 euro. Drejtoreshë çfarë masa keni ndërmarrë, kur po e shohim një drejtori që nuk është në buxhet, asnjëherë specifika dhe raport s'kemi marr prej kësaj drejtorie, çka jeni tu planifikuar?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ju kisha lut që të rrimë te rendi ditës, edhe ta respektojmë kohën, ju kisha lutur të flasim për bartjen e të hyrave, se nuk jena këtu te pyetje përgjigje.

z.Muhamet Ademaj; Ne i dëgjuam edhe grupet parlamentare. Këto kërkesa janë ardhur nga ekzekutivi dhe e dimë që më së shumti përfitojnë qytetarët e Komunës së Shtimes nga këto mjete, nuk dua më tëpër me zgjat ne si grup LDK-AKR e përkrahim bartjen e mjeteve të hyrave vetanake nga viti 2023 në vitin 2024, sipas propozimit.

z.Përparim Ramusa; Dua me replikuar me Bsinikun, i mirë është ai që nuk shitet as nuk blihet e nuk shantazhohet. Te bartja e të hyrave nuk mundem me votuar si grup parlamentar, kur nuk keni parapa pare për ujësjellës për fshatrat Zborc, Pjetershticë dhe Carralevë që nuk kanë ujë të pijshëm. Pajtohem plotësisht me Reshatin. Besnik mos i hyn në hak Arsimit se Arsimi në Komunën e Shtimes është në gjendje të keqe. Të thuhet nuk ka bërë qeverisja e kaluar asgjë për Arsimin është absurde. Për një mandat Besnik qeverisja e PDK-së e ka ndërtuar shkollën në Pjetërshticë, në Carralevë, në Muzeqinë edhe Çerdhen në Shtime, ti ose ke problem me dioptrinë, ose je tu deshtë me i fsheh faktet. Pajtohem se Arsimi në Komunën e Shtimes është keq, nuk ka furnizim të shkollave me projektor e llaptop, pajtohem këtu plotësisht me Reshatin që ta përkrahim këtu Arsimin. Besnik pasi jena këtu e ki mundësin, propozo të hyra me i bartë në Arsim, unë ta jap përkrahjen.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Atëherë gjithë e kanë marr fjalën edhe për herën e dytë, ju falenderoj për këtë pjesë, të gjithë folën shefat e grupeve edhe në emër të grupeve, nuk na mbetet gjë tjetër vetëm me hedh në votim dhe të vazhdojmë tutje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për”, me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”, miratoi Vendimin për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024.**

Pika 5

Prop-Vendim për formimin e Komisioneve për ndarjen e çmimeve “Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi”

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, nënkupton se kjo pikë në seancën e fundit e kemi kaluar vendimin për qelsin e formimit të Komisionit. Në këto dy komisione do të jenë nga pesë anëtarë dy nga Kuvendi, dy nga Ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Unë kam kërkuar nga opozita por edhe nga pozita në KPF që sot të na e sjellin emrat në Kuvend. Uroj që të jetë një komision gjithëpërfshirës, unë fillimisht kisha kërkuar prej shefave të grupeve që të na japin me radhë emrat.

z.Rexhep Gashi; Pikërisht na jemi për këtë propozim-vendim, por në mbledhjen e kaluar dhe diskutimet e mëhershme kemi vetëm një të propozuar nga Kryetari jo dy, kemi informata këtu do të

jetë një grup gjithëpërfshirës ku Kryetari duhet të propozoj vetëm një anëtarë, e shoqëria civile po mendoj të jenë me dy të përfshirë, kështu do të jetë shumë më transparente.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Zotëri Gashi ne e kemi votuar qelsin në seancën e kaluar dhe qelsi është prej 5 anëtarëve, nuk besoj që sot duhet të rishqyrtohet kjo e ta fusim prapë në votim.

z.Reshat Mujota; Edhe unë jam pro këtij Propozim–Vendimi edhe qelsit prej 5 anëtarëve. Po faktikisht në mbledhjen e kaluar e kemi pasur dy anëtar te Kuvendit, dy anëtar shoqata civile një anëtarë Ekzekutivi dhe një anëtarë Shoqatat e dala nga Lufta, kështu e kemi pasur, dhe tash në këtë diskutim e kemi që dy anëtarë të propozuar nga Kryetari unë kam thënë që Kuvendi nuk i voton anëtarët e vet. Por sot si do që të jetë kam propozuar që një anëtar të jetë nga Organizatat e dala nga Lufta.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Nuk ka qenë kështu, i njëjti material është.

z.Reshat Mujota; Nuk e di nëse ka gabim teknik. Kuvendi ka me i votuar gjithë këta emra. Po pajtohem që qelsi me kanë prej 5 anëtarëve por jo në qet mënyrë dy të jenë nga Kryetari.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Është dy anëtar nga Ekzekutivi ku bënë pjesë edhe administrata. Ne e kemi votuar qelsin në seancën e kaluar dhe i njëjti material u kanë, vetëm qelsin e kemi votuar prej 5 anëtarëve, me shpjegimin që sot do të votohen emrat, a është kështu zotëri Ramusa, kështu jemi dakorduar edhe në KPF. Bashkërisht kemi kërkuar që sot të vijmë me emra në seancë, dhe ju kisha lutur që shefat e grupeve të na japin emrat.

z.Muhamet Ademaj; Në emër të pozitës grupi LVV-LDK-AKR e propozojmë për anëtare të komisionit “Nderi i Qytetit” zonjushën Rrezarta Ramadani.

z.Përparim Ramusa; Plotësisht jam dakord me ty Kryesues që në mbledhjen e kaluar e kemi votuar qelsin, po është një telashe Kryesues që ju jeni zotuar që keni me i pru emrat e propozuar nga Ekzekutivi dhe shoqëria civile.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; I kam emrat tani do ti lexoj.

z.Përparim Ramusa; Duhet me i pasur emrat dhe një biografi tyre, sepse jemi tu fol për një çmim më të lart që epet “Nderi i Qytetit” dhe Qytetarë Nderi”. Kemi dëshirë si Kuvend me i pasur emrat dhe me pas një biografi të tyre edhe pastaj me dal në votim, jo në këtë formë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Zotëri Ramusa ti japim gjitha propozimet, pastaj unë do ti lexoj të gjithë emrat para se me hy në votim. Pasi që janë dy komisione ju merruni si opozitë, ndoshta një PDK-ja e një ku ta di unë, sepse nëse nuk i kisha emrat unë normal që do ta hiqja prej rendit të ditës. Për ata e kemi lënë një muaj.

z.Përparim Ramusa; Ne po e dimë që ti i ke emrat dhe këta emra është dashur me na ardhur me material të Kuvendit, se na tash s’mundemi me votuar pa i ditë. Ti e ke ditë ndoshta qe një muaj por na s’pe dimë. E udhës ka qenë bile këtu në mbledhje me na i dhënë emrat. Me u marrë vesh na si grup parlamentar se a ja vlen personat e tillë me hy në këto komisione. Kishim pas dëshirë me na i pru emrat, me na i dhënë një pauzë edhe të dakordohemi edhe na.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Atëherë unë po e shoh që këtu nuk ka emër Zotëri Ramusa.

z.Përparim Ramusa; Na nuk është që kem problem me caktuar emrin, por po i kërkojmë emrat prej juve prej ekzekutivit dhe shoqërisë civile.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Zotëri Ramusa e thjeshtë është ma jep propozimin nga PDK-ja. Unë jam Kryesues po kërkojë propozimin që i takon Kuvendit. Do të thotë LDK-AKR ma dhanë emrin e zonjushës Rrezarta Ramadani, ma jepni edhe ju emrin edhe ti plotësojmë komisionet, edhe unë do ti lexoj para me shkuar në votim.

z.Përparim Ramusa; Një sqarim, s’mundemi na me dhënë emër deri sa ti shohim na emrat nga Ekzekutivi. Këta emra kanë me u votuar në pako. Nuk mundemi na me dhënë emra mandej me dal kundra propozimit tonë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Nëse nuk keni emra atëherë vazhdojmë me komisionin “Qytetarë Nderi”

z.Besnik Seferi; Ndoshta isha pajtuar për atë çka thotë Përparimi, që thotë te ipen emrat nga akzekutivi, sa i përket shoqërisë civile na nuk mundemi me ua imponuar e kanë votuar ata që me qenë pjesë e këtij komisioni. Qelsi që është dy nga Ekzekutivi dy nga Kuvendi Komunal është mirë të miratohet si i tillë.

znj.Zenije Veliu; Atëherë Kryesues ne si grup e propozojmë Besnik Seferin për Komisionin “Qytetarë Nderi”

z.Reshat Mujota; Po Habitem edhe shoqëria civile edhe ekzekutivi ne të propozon, ken të donë unë ka me ua votuar këta emra, esenca është a po ja voton Kuvendi. Kuvendi është tu e formuar këtë Komision, nuk do të thotë që shoqëria civile ken ta dërgon na me e votuar edhe le të vjen kush donë. Në qoftë se nuk pajtoj unë më një anëtarë të shoqërisë civile unë s’ mundem me dhënë votë këtu. Unë propozime nuk kam, më e mira u kanë, këtu ka Kuvend jo opozitë e pozitë, që anëtarët e vendosin cilët me qenë nëpër këto komisione, duhet dakordohemi pozitë e opozitë. Ku e dimë na kështu, kisha kërkuar nëse nuk prish punë, lexoj emrat e shkojmë një pauzë dhe shkojmë në votim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pajtohem plotësisht me zotëri Mujotën , nëse e vërejtët pozita përbehet prej tri subjekteve dhe janë dy propozime, unë kërkova që edhe opozita ta ketë një anëtar nga opozita një anëtar nga të pavarur. Nëse nuk keni propozime merren nga subjektet tjera, të mos bëjmë politik me këtë komision. Më falni më duhet me i lexuar emrat, do të thotë për Komisionin “Nderi i Qytetit” nga Kuvendi nga koalicioni LDK-AKR është propozuar zonja Rrezarta Ramadani, PDK nuk na dha emrin ende, i emëruar nga Kryetari prej Ekzekutivit është zotri Idajet Rexhepi dhe Nënkryetari i Komunës zotri Faruk Beqa dhe nga shoqëria civile është Abdyl Hajredini gjith e njohim është një kuadër që i bënë nderë këtij komisioni dhe vjen nga shoqëria civile një mësimdhënës ish drejtor shkrues i librave. Te i dyti komision “ Qeytetar Nderi” nga pozita është propozuar zoteri Besnik Seferi nga ekzekutivi Valon Januzi Drejtori i Administratës dhe nga Kryetari, është propozuar edhe Ruzhdi Jashari, është një figurë publike që e njohim te gjithë, kurse nga shoqëria civile është një njeri i nderum që është Fadil Hysaj Profesor, besoj që edhe ky nga shoqëria civile i bënë nderë me qenë në këtë komision dhe me ndihmuar për ndarjen e këtyre çmimeve.

z.Përparim Ramusa; Kryesues shumë lehtë koka kanë, vetëm na jep neve 5 minuta pauzë si opozitë kemi me ti dhanë dy emra. Gjithë emrat që janë këtu për mua janë të pranueshëm, por kur hezitoshje ti me i dhënë emrat, thosha mos po vjen ndonjë far anëtarë prej Fushë Kosovës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Atëherë zotëri Ramusa pajtohet në emër të grupit që të jenë këta emra, përveç propozimeve qe ende nuk i kanë dhënë si opozitë, 5 minuta pauzë për konsultime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pas 5 minutave pauzë po vazhdojmë me mbledhjen.

znj.Adelina Beqa; Te komisioni “Nderi i Qytetit” si opozitë propozojmë zotëri Përparim Ramusa.

z.Lumni Amrushi; Te komisioni “Qytetarë Nderi” nga opozita propozoj zotëri Reshat Mujta.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Atëherë po i lexoj edhe një herë emrat e te dy Komisioneve.

Komisioni për ndarjen e çmimeve “Nderi i Qytetit” do ta ketë këtë përbërje: Rrezarta Ramadani, Përparim Ramusa, Idajet Rexhepi, Faruk Beqa dhe Abdyl Hajredini. Komisioni për ndarjen e çmimeve “Qytetar Nderi” do ta ketë këtë përbërje: Besnik Seferi, Reshat Mujota, Valon Januzi, Ruzhdi Jashari dhe Fadil Hysaj.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miraton në paket dy Vendimet për formimin e Komisioneve: Komisioni për ndarjen e qmimit “Nderi i Qytetit” dhe Komisioni për ndarjen e qmimit “Qytetar Nderi”.**

Pika 6

Prop-vendim për caktimin e çelësit për zgjedhjen e komisioneve për ndarjen e çmimeve “Sakrifica Reçakut-1999” dhe “Pena e Artë”

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Kjo do të thotë është e njëjtë sikur në seancën e kaluar që kemi votuar qelësin për këto dy komisionet që sapo u miratuan, kjo nënkupton që në seancën e radhës të vijmë emrat e të votohet përbërja e Komisioneve. Në KPF jemi dakorduar që edhe ky komision të jetë me 5 anëtarë, a jeni të pajtimit

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për caktimin e çelësit për zgjedhjen e komisioneve për ndarjen e çmimeve “Sakrifica Reçakut-1999” dhe “Pena e Artë”**

Pika 7

Draft-Rregullore Komunale për Transparencë, (pas diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Këtu e kemi pasur vetëm një ndryshim të vogël të ky propozim-rregullore, dhe zyrtarët e zyrës për informim i kanë dhënë sqarimet. Është një dokument që duhet të kalohet përmes Kuvendit, diskutimi publik është mbajtur. Përndryshe në KPF është votuar që të kalojë kjo pikë e rendit të ditës. Edhe për këtë më bëjnë me dije shefat e grupeve që të shkojmë direkt në votim.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”, miratohet Rregullorja Komunale për Transparencë.**

Pika 8

Draft-Plani i veprimit për transparencë komunale 2024-2028, (pas diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Ngjashëm është edhe Draft-Plani i veprimit për transparencë komunale 2024-2028, (pas diskutim publik), edhe kjo në KPF është kaluar unanimisht dhe i rekomandon Kuvendit që të kalojë si pikë e rendit të ditës. Edhe për këtë më bëjnë me dije shefat e grupeve që të shkojmë direkt në votim.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”, miratohet Plani i veprimit për transparencë komunale 2024-2028**

Pika 9

Draft-Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës 2024-2026

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Edhe kjo do të shkojë në diskutim publik, edhe këtë do ta votojmë në votim të drejtpërdrejtë, që ta dërgojmë në diskutim publik si Kuvend.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Planin e Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026.**

Pika 10

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Më në fund erdhëm te pika e shumë përfolur Pyetje Përgjigje”, a keni me diskutuar apo të kalojmë në pikën tjetër, çka të bëjmë me këtë pikë. Po më duket që i keni kryer në fillim Pyetjet. Po ju kërkojë diçka sinqerisht nëse kish qenë e mundur pyetjet mi dërguar të shkruara, ti mbani në seancë të shkruara dhe ti dorëzoni, që pastaj edhe përgjigjet të ju open më të sakta dhe ta ketë edhe Procesmbajtësi ma të lehtë. Është tu na përcjellë kjo nga disa seanca që nganjëherë pyetjet nuk po janë të formuluar në mënyrën ma të mirë të mundshme.

z.Reshat Mujota; Kam pyetje për DZHE-në, konkretisht me çështjen e serrave, kur do të shpërndahen ato serra, dhe pyetje e dytë për DZHE-në tek grandit “Mushqerra” edhe te kjo kur do të shpërndahen, sepse kam pyetje nga qytetarët, mundësisht sot të më njoftoj kur është afati i këtyre shpërndarjeve? Te DSHP-ja kam pyetje por sot nuk koka drejtori këtu, për deponit ilegale, kam bërë pyetje disa herë, por nuk pe shoh në tëren që është duke u bërë një punë e mirë. Jashtëzakonisht është shqetësuese, çka po më shqetëson më së shumti rruga “Islam Neziraj” është tmerrësisht e ngarkuar me mbeturina ilegale. Tashmë kjo rrugë është bërë shumë rrugë të cilën e frekuentojnë shkaku i kullës, kisha pas dëshirë që Drejtori mundësisht të ndërmer diçka të pastrohet ajo pjesë e rrugës. Te DPUGJK-ja, si kërkesë ka qenë edhe më herët por prapë tani po e shfrytëzojë rastin me bërë edhe një herë kërkesë për rregullimin e kanalizimit të kullës. Kulla është pa kanalizim vetëm me gropë septike, kisha pas si kërkesë prej drejtorit ose sot të na jep sqarime ose të përgjigjet me shkrim që kur do të bëhet kanalizimi te kulla në Mollopolc. Këto janë pyetjet e mia.

z.Shkurte Mustafa; Kam pyetje për DPUGJK-në, kur priten të fillojnë punimet në rrugën “17 Shkurti” në Godanc të Poshtëm. Gjithashtu pyetje për DKA-në, a ka përfunduar sistemi i montimit të alarmeve dhe kamerave në shkollat e Komunës tonë.

z.Rrezarta Ramadani; Përshëndetje, pyetja ime është për DPUGJK-në, gjatë rregullimit të kanalizimeve në rrugën “William Woker” kanë ndodhur disa dëmtime në trotuare dhe në rrugë, kur priten këto që të rregullohen?

z.Muhamet Ademaj: Kam këto pyetje: Pyetje për DZHE, sa është numri i bizneseve aktive në Komunën e Shtimes dhe pyetje e dytë shkon për DKA, pse nuk po fillojnë procedurat për emërimin e shkollës së mesme profesionale?

znj.Adelina Beqaj: Kam edhe unë disa pyetje, pyetje për Kryetarin; Pyetjen e parë po dua me dedikuar për stacionin e autobusëve, ju keni premtuar gjatë fushatës që do ta kenë një vend ndalje për autobus dhe do të jetë në qytetin tonë, një stacion i autobusëve gjë që nuk është duke ndodhur tash e sa e keni marr mandatin. Pyetje tjetër është për Kryetarin, ju keni bërë premtim taksistëve që do të kenë vendqëndrim, ndërsa tani as në zyre spo i pranoni për me i ditë shqetësimet e tyre që i kanë? Pyetje tjetër është për DPUKGGJ, në bazë të cilave kritere jeni duke i shtruar rrugicat në Komunën e Shtimes? Pse po bëni rrugica jo cilësore ku dihet që vetëm sa për fotografi po i bëni, ndërsa pyetje tjetër është për Kryetarin, te QPS-ja keni bërë një katrahurë, duke e mbushur me punëtor me kontrata të pa arsyeshme duke pasur parasysh punët e ndjeshme që janë në QPS, dhe aty dihet se duhen punëtor profesionistë edhe pse po vazhdon Qendra për Punë Sociale pa drejtor ende dhe vetëm me një ushtrues detyre, që tash ka kaluar edhe një vit e që nuk është zgjedhur. Edhe një pyetje tjetër, keni premtuar për një qasje më të lehtë të prindërve që i dërgojnë fëmijët në shkollë, konkretisht te shkolla fillore “Emin Duraku” dhe sot ende po ballafaqohen prindërit me pengesa dhe rrezik të lartë kur dërgohen fëmijët në këtë shkollë, do të thotë ende fëmijët ballafaqohen me pengesa dhe rrezik të lartë.

z.Rexhep Gashi: Pyetje për Kryetarin, çka është ndërmarrë për ujësjellësin në Pjetërshticë ku Kryetar keni premtuar se qysh në mandatin e parë do ta rregulloni këtë çështje? Çka është duke ndodhur me ndërtimin e ndërtesave të quajtura ndërtesat e Fitores deri ku e keni dërguar këtë rast për të cilin mu personalisht dhe qytetarëve ju keni premtuar se do të rregullohet dhe të kemi votuar. Pyetja e tretë çka është duke ndodhur me një reklam që po e bëni që e keni bërë një laborator 24h, jam për me ju përgëzuar për punën të cilën jeni duke e bërë unë mendoj se para se me u bë reklama dhe të filloni këtë aktivitet, mendoj që do të bëhet një punë shumë e mirë që të bëhen analizat me parametra shumë reale, unë mendoj se analizat e këtij laboratorin nuk janë reale ku pacientët po ankohen që analizat nuk po ju bëhen mirë dhe po detyrohen të ju nënshtrohen një terapie të panevojshme, e kam një ankesë këtu janë disa dokumente që mundem me ju dhënë juve me pa se qysh i kanë dal analizat një qytetari në Laboratorin në Shtime në QKMF me datë 14 dhe si i kanë dal analizat në një laborator tjetër privat me 13, ti besoj duhet me pas interesim, ti je Kryetar, ku këto analiza kanë ra në kundërshtim, ku qytetari u detyrua me shkuar te laboratorin i tretë në Prishtinë për mes me ju nënshtroar një terapie të pa nevojshme ku në QKMF i ka dal analiza shumë e ngritur. Pyetje tjetër për DPUKGGJ, e kam një shqetësim, në buxhetin 2023-2024 e kemi trotuarin, e ndriçim në rrugët “Pjetërshtica”, “Kastrati” dhe “Bushati”, në Gjyrvoc, me përgjegjësi të plot mund të themi se në asnjë rrugë nuk është punuar asnjë projekt, e kemi një kontratë dhe e kemi gjendjen që nuk është punuar në këto tri rrugë as trotuar as ndriçim ndërsa kontrata me operatorin është lidhur dhe menaxheri i kontratës e lypë një sqarim në mënyrë fizike ku thotë jena tu punuar në këto rrugë. Mendoj edhe ajo është një mashtrim qe çfarë sqarimi më ka dhënë shumë të thjeshtë ”lexoi sqarimin lidhur me punët e kontratës 03/01/059 të datës 03.04.2023 me numër identifikimi 617-23-5321-2 në vitin e parë është kontraktuar në vlerën prej 14.000 euro, kjo mendoj se është vepër penale dhe i ftoj organet të merren me këtë rast. Te qeverisja e kaluar kemi pasur vërejtje gjithmonë për specifikim te projekteve, të specifikohen rrugët jo të thuhet në brendësi të fshatit, ndërsa ju hala ma keq, përmendeni këto rrugë por pa e llogaritur kohën për punët në këtë rrugë. Është kjo vepër Penale ku kontratën e keni nënshkruar pa paramasë, a sa bahen ato rrugë ku janë specifikuar ato rrugë, ndërsa puna është bërë në rrugë tjera. Pyetje për Kryetarin; Pse shoqërinë me aftësi të kufizuar që është një shoqëri shumë e ndjeshme nuk e keni rahatuar, unë personalisht kam një qytetar nga fashiti Mollopolc që e ka ngritë shqetësimin e ka drejtimin adekuat ku ka konkuruar dhe nuk është pranuar, dhe pse nuk i keni ofruar mundësi dikun tjetër atij personi?

z.Përparim Ramusa; Unë pyetje shitesë nuk kam, por deshta të lidhem me parafolësin për këtë shqetësim që e ngriti. Tema e parë ke për rrugët në fshatin Gjurkoc, tjetër rrugë është bërë planifikimi, tjetër rrugë janë marr paramasat e tjetër rrugë është shtruar. Nëse është kjo e vërtetë ju bëjë apel Hetuesisë, Prokurorisë që të vinë dhe ta hulumtojnë rastin se sipas mendimit tem kjo është vepër penale. Është vepër që duhet merret më te Hetuesia dhe Prokuroria. Te shqetësimi i dytë që ngriti parafolësi, këtu po flas edhe në aspektin profesional është shqetësuese, duke marrë parasysh që Kryetari i Komunës është me profesion mjek. Nëse analizat e laboratorit të QKMF-së në Shtime nuk janë reale atëherë është shqetësuese për gjithë popullatën e Shtimes. Sipas një raporti që e kam këtu që parafolësit ja mora ta shikojë si profesionist, është një analizë që e tregon funksionin e veshkëve, konkretisht kreatina, që në Laboratorin e QKMF-së u dalë bajagi i lartë kurse në laboratorin privat është dal sipas normales, kjo nëse është e tillë është shqetësuese. Duke marr parasysh po flas në aspektin profesional mjeku terapinë pacientit ja përshkruan sipas tre faktorëve: ekzaminimin e pacientit, analizat laboratorike dhe në parametrat vital, kështu që te analizat jo të sakta edhe profesionistët mundem me dal keq para pacientit. Ju bëjë apel Kryetarit të Komunës dhe drejtorit të shëndetësisë që kalibrimin dhe reagencat ti kontrollojnë që analizat e qytetarëve t'ju dalin ashtu siç i kanë në realitet.

z.Besnik Seferi: Kam këto pyetje. Pyetje për Kryetarin; Meqenëse shërbimet laboratorike për 24h tashmë veç se do të bëhen për të gjithë qytetarët e Komunës së Shtimes, një praktikë e tillë e shërbimeve a do të bëhet edhe në shërbimet e stomatologjisë. Pyetje për DSHP; Në rrugën “Dëshmorët e Reçakut” ka filluar për me qenë rrezik në rrugë për shkak të shpejtësisë së veturave, sa është mundësia me filluar me qenë dy polic të shtrirë aty siç ju thojmë ne apo më mirë me thënë pengesa në rrugë aty. Pyetje për DKA; Pyetja është për shkollën “Skënderbeu” në Çest të Reçakut, kur do të jetë e paraparë që të realizohet projekti i ndërtimit të sallës sportive i cili veqse ka filluar? Pyetje për Kryetarin; Sa i përket çështjes së stacionit të vjetër të Policisë, çka është planifikuar që të bëhet apo të jetë, ky stacion? Pyetje tjetër për DSHP; Kur do të hyjë në zbatim rregullorja për orarin e punëve të bizneseve pasi që qytetarët po e presin?

z.Gëzim Haxhiu: Kam këtë pyetje; Pyetje për DPUKGJ; Kur pritet të bëhet rregullimi i trotuarit në rrugën “Fejzullahu” në Muzeqinë. Pyetje për DPUKGJ, a pritet që gjatë këtij viti të bëhet rivitalizimi i rrugës “Sami Frashëri” në Shtime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Vazhdojmë me përgjigjet e drejtorëve nëse dëshirojnë të përgjigjen këtu apo me shkrim.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Përshëndetje, faleminderit zotëri Mujota për pyetjen. Me qenë se drejtorja e Bujqësisë është ndarë nga ne por po përgjigjem mbase kemi qenë pjesë e proceseve. Te çështja e serrave vetëm se ju kanë dal mjetet nëpër llogari kam informacione se edhe kanë filluar me u ndreq këto sera. Sa i përket projektit “Myshqerra” është një numër i madh i aplikuesve, javën e kaluar kanë filluar me dal nëpër teren komisioni, kështu që po besoj deri në fundin e Prillit kanë edhe me u krye, në bazë të raportit të drejtorit po flas që tashmë është në dikaster të tina kjo çështje. Sa i përket pyetjes së profes Muhamet Ademaj sa biznese janë aktive në Komunën e Shtimes, në Komunën ton kemi deri me datën 31.12.2023 janë të regjistruara 2214 biznese aktive, 1969 janë në emër të meshkujve si dhe 245 femrave, kemi pasur edhe 103 hapje të reja të bizneseve.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUGJK; Përshëndetje do ti jap përgjigjet në disa nga pyetjet. Sa i përket kanalizimit të kulla në Mollopolc, ka qenë kërkesë në vitin e kaluar në fund të vitit dhe s’kemi mundur me buxhetu, do të kryhet gjatë këtij viti kemi edhe kërkesa nga qytetarët, që do të ndërtohen edhe 4 shtëpi të reja në atë pjesë, por edhe nga këshilli i fshatit Mollopolc lidhje me kanalizimin e kullës. Mu ndërlihd te shkurte Mustafa sa i përket rrugës “17 Shkurti” në Godanc të Poshtëm mendoj që brenda muajit Mars do të fillojnë punimet dhe jo vetëm në këtë rrugë por në të gjitha pjesët ku ka kontratë dy vjeçare. Sa i përket rrugës “William Woker” kanë mbet edhe 280 metra kanalizim fekal prej kontratës së vitit të kaluar me u përfunduar. E kemi në buxhet të Qeverisë rrugën “William Woker” afër 250 mijë euro që është 1100 metra prej rrugës prej shkollës “Emin Duraku” deri ne hyrje e rrugës “15 Janari” në Reçak. Sa i përket shkollës fillore “Emin Duraku” problematika te kjo shkollë. Pyetjen që e bëri Adelina Beqa më bëri përshtypje. Jemi duke menduar si qeverisje që me bërë aty një rreth rrotullim që të bëhet zgjidhja përfundimtare i çështjes rreth nxënësve, ku nuk do

të bllokohet më rruga. Sa i përket pjesës në fshatin Gjyrkoc, unë kam biseduar pak edhe me Rexhën në zyrën time, gjitha janë të planifikuara në buxhet, projektet që janë në buxhet kanë me u kry para afatit dy vjeçar, viti i parë ka qenë 15 mijë euro, pjesa tjetër është me sa e di 85 mijë euro. Mirëpo sa i përket shqetësimeve, jo vepër penale jo kjo, ka pasur më herët që janë shtruar edhe rrug të Komunave tjera pa asnjë marrëveshje ndër komunale me buxhet të Komunës së Shtimes, nëse doni me dit është rruga “Devetakut” ku gjysma e rrugës është shtruar në pjesën e Komunës së Ferizajit, kjo ka ndodhur në vitin 2021 me buxhet komunal me taksa tona. Jam i hapur për të gjithë ndesh në zyre ndesh në Kuvend. Për pengesat në rrugë, te rruga “Dëshmorët e Reçakut” po flasim për rrugën që dërgon deri te shkolla fillore. Kërkesa për pengesa në rrug zakonisht duhet me na ardhur nga një shumicë e banorëve që jetojnë në atë lagje. Na kan ardhur dyfish kërkesa, një pjesë e banorëve thonë me vendos pengesa, ndërsa pjesa tjetër nuk donë pengesa. Ne në atë lagje kemi vendosur një trotuar për çështjet e rrezikut që shkojnë te shkolla fillore, ku besoj që edhe trotuari edhe pengesat unë besoj se janë të tepërta me u bërë njëkohësisht të dyja. Mirëpo kërkesat që vijnë nga banorët e kësaj lagje janë shtyese që na me ndërmarrë masa. Sa i përket trotuarit në rrugën “Fejzullahu” është e buxhetume që vazhdimi i trotuarit me shkuar nga fshati Muzeqin deri në fshatin Vojnoc. Po ashtu edhe ndriçimi te rruga “Sami Frashëri” e kemi me kod buxhetor të përcaktume rrugën “Sami Frashëri” nuk e di koston sa do të kushtojë, kemi edhe kërkesa për asfaltime të rrugicave në këtë pjesë që janë, kështu që presim në ditët në vazhdim me marr çfarë kosto ka.

z.Përpraim Ramusa; Kam replik te drejtori.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Letë përfundojnë Ekzekutivi një herë mandej ju jap fjalën, sepse e kemi bërë si rregull kështu.

z.Përpraim Ramusa; Kryesues në rregullore të Kuvendit që e kemi votuar vet, pas përgjigjes së drejtorit asambleisti ka drejt në replikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Nuk po e thamë që nuk ke drejtë, po i dëgjojmë me radhë drejtorët edhe pastaj mbani shënime edhe repliko për secilin drejtor. Nuk jam duke thënë që po ta ndalojë replikën.

znj.Yllka Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; E dim që gjendja në Arsimin ton nuk është e mirë prandaj për këtë vit kemi ndarë buxhet për Sallën e shkollës në fshatin Reçak dhe në fshatin Godanc. Javën e kaluar kemi pasur takime me projektuesit që ti kryejmë projektet lidhur me këto, mandej do ti dërgojmë në procedurat e prokurimit, kështu që konsideroj si çështje të kryer.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Përhëndetje për të gjithë asambleistët e pranishëm, përhëndetje për gjithë qytetarët që po na ndjekin, mediat. Po mundohem me i përmbledh disa pyetje që u adresuan këtu. Zotëri Gashi sa i përket ujësjellësit dhe objektit të Fitores i ke të shkruara në email, duhet me i lexuar, sapa mi konfirmuan, vetëm lexoj dhe në qoftë se nuk ti kam kthyer përgjigjet prapë i bënë. Personat me nevoja të veçanta që pyete nuk ndjehemi mirë, ne e kemi trashëguar një situatë që prej 700 punëtorëve, asnjë nuk ka qenë me nevoja të veçanta, realisht nëpër konkurse fatkeqësisht personat me nevoja të veçanta nuk ja kanë dal me fituar një vend të punës, por unë kam folur edhe me Ministrin e Financave dhe Ministrin e Administratës së MPB-së që ashtu duhet me bërë një specifik të caktuar që personat me nevoja të veçanta mos me pas kritere të caktuara të njëjta me personat pa nevoja të veçanta, në mënyrë që edhe kjo kategori me i pasur mundësit me përfituar një vend të punës. Jemi tu punuar në këtë drejtim, shumë shpejt keni me parë që ka me pasur edhe raste konkrete të përmirësimit në këtë aspekt. Sa i përket Laboratorit në QKMF 24 orë, po është e vërtetë është një nga zotimet tona dhe stafi jonë ndihemi krenar për këtë, dhe kjo është pritur shumë mirë nga qytetarët, kemi marr qindra komplimente për këtë. Do të mundohemi që ta mbajmë me një gamë të gjerë të analizave në pjesën e mesnatës, kur urgjencat munden me qenë të tilla që mund të ju kushtojnë me jetë njerëzve ose qytetarëve të Komunës së Shtimes. Sa u përket dyshimeve për vlerat laboratorike që u bënë nga zotëri Gashi dhe zotëri Ramusa. Unë sinqerisht, aty janë më shumë se gjashtë laborant, aty ka edhe mjek, e integriteti e profesionalizmi të hidhet në dyshim, unë nuk kisha pasur qejf me krijua kësi dyshime në profesionalizmin e tyre, sepse aty ka laborant që janë prej 30 viteve qëndrimi në detyrë dhe janë profesionistë të fushës, ku një aludim i tillë vë në dyshim profesionalizmin e tyre. Ne që jemi në fushën e mjekësisë e dimë që herë pas here dy faktor munden me qenë kryesor ku një vlerë, parametër laboratorik mundet me pas shkarje, është kalibrimi i

aparaturave një, faktori kryesor edhe faktori i dytë është afati i skadencës së reagencave, p.sh. nëse njëra ka qenë kreatinë mundet me ndryshuar nga këta dy faktor, por nëse integriteti dhe profesionalizimi i laboranteve, mjekëve vuhet në dyshim nuk është mirë, të cilët janë shumë të ngarkuar edhe me shumë profesionalizëm mundohen mi krye punët, për me mujt me i mbuluar kërkesat e shumë palëve për analiza. Megjithatë sa i përket pjesës së kalibrimit të aparaturave edhe verifikimit të afatit të skadencave të reagencave, unë kam marrë shënime, edhe do ti diskutojë me kolegët që këto të kontrollohen. Zotëri Seferi tha, a do të ketë shërbim 24 orë edhe për Stomatologjinë. Zotëri Seferi zakonisht Stomatologjia nuk ka urgjenca, por mund të ketë dhimbje e cila menaxhohet në Urgjencën e QKMF-së me anagjetik edhe pret, dhe nuk është praktik as në QKMF-ë e qyteteve të tjera me qenë ky shërbim 24 orë, nëse ka ndonjë hemoragji eventuale që janë shumë të rralla është Qendra Klinike Universitare, përkatësisht dikasteri i Stomatologjisë që i trajton, por këto janë shumë të rralla, për mos me thënë nuk ka asnjëherë. Ne do të mundohemi orarin ditor ta zgjasim deri në ora 20:00 në mënyrë që shërbimet Stomatologjike të merren në 12 orë brenda ditës, po ashtu edhe shërbimet Stomatologjike të shtrihen edhe nëpër shkolla siç ka ndodhur deri tani. Për Stacionin e Vjetër Policorë, ne e kemi menduar këtë si objekt për me shfrytëzuar si muze të dhimbjeve, sepse ne e dimë që aty me dekada të tëra janë torturuar njerëz nga pushteti hegjemon Serb, deri në alivanosje do të thotë me tortura mizorisht barbare e çnjerëzore. Mirëpo kriteret e shpalljes Muze të një objekti janë kriteret që përcaktohen nga Ministria e Kulturës, ku në një kërkesë të tillë e kemi adresuar në Ministrinë e Kulturës nëse aprovohet mirë, në të kundërtën nëse nuk aprovohet ne jemi duke Zhvilluar Planin Komunal, ku do të ulemi e do ta gjejmë një mënyrë për ta rregulluar. E kam parë që gjendja është e pakëndshme, por besoj që brenda këtij viti ne do të vendosim për destinimin e këtij objekti.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Tani e dini që i keni nga dy minuta për përgjigjet që nuk ju ka dhënë Ekzekutivi, dhe pastaj këtu përfundon gjithëçka.

znj.Adelina Beqaj; Pe shoh sot që disponimi i Kryetarit koka me na injoruar, e pash në mimika të ftyrës gjatë kësaj pike por edhe gjatë seancës. Kryetar ta bana një pyetje rreth QPS-së të lutna përgjigju se ki përgjegjësi ndaj qytetarëve të Komunës së Shtimes.

z.Rexhep Gashi: Nuk kam pyetje por një reagim për Kryetarin që tha ti kam kthyer përgjigjet i ke ne email, nuk e di Kryetar në email te kujt ja ke dërguar, nëse sekretaria nuk e ka dërguar është diçka tjetër. Pyetjen çka është puna me ujësjellësin në Pjetërshticë, pyetja ka qenë kështu. Unë e kam cek ti Kryetar ke premtuar që kjo do të kryhet në vitin e parë të mandatit, ndërsa mua nuk më ka ardhur kurrfar përgjigje. Pyetja sa i përket ndërtesës së Fitores nuk e kam as si pyetje ktu të shkruar as përgjigjen e juaj. Këtë punën te stafi i Laboratorit unë punën profesionale nuk e kontestojë, por unë dyshoj tek kalibrimi i pajisjeve dhe afatit të reagencave, ku e kanë afatin e vet. Unë nuk po thamë ashtu sikur ti e dhavë përgjigjen. Nëse nuk i beson realitetit janë letrat me datë 13 e 14 dhe me 16, ka qen njeri ka hy në terapi, nga këto rezultatet e pa sakta. Nga ana e stafit profesional shumë kam respekt për ata, janë shumë të afët nga ana profesionale, po mbikëqyrje duhet të ken, planifikime duhet të kemi. Kryetar e kemi rastin Rentgenit nuk është tu punuar, për një fotografim të thjeshtë detyrohen njerëzit me shkuar në Spital me bërë. E kemi akuzuar pushtetin e kaluar që janë tu shtruar asfalt nëpër oborre, napër rrugica ku operatorët po ankohen që nuk po kemi ka e kthejmë makineritë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Zotëri Gashi tu kisha lutur, jemi te pika Pyetje dhe Përgjigje. Ju kisha lutur që të keni pyetje saktë, sepse nuk do ta lejoj këtu, ka than, i ka thanë, janë kanë, nuk po më intereson ajo pjesa e te kaluarës. Nëse keni pyetje te saktë urdhëroni, jepni pyetjet i merrni përgjigjet.

z.Përpraim Ramusa; Deshta mu ndal te përgjigja e Kryetarit, lidhur me profesionalizmin e zyrtarëve mjekësor. Askush nuk po e konteston këtu profesionalizmin e tyre, janë në nivel të detyrës, por kërkesa ke te aparatura. I potencoj edhe Rexhepi, dëshmitë janë, prandaj kërkuam si grup parlamentar në mbledhjen e radhës me debatuar për shëndetësi. Te drejtori i DPUGJK-së, drejtor e ke përmend disa herë edhe tash e përmende që ka pasur abuzime. Ta kam thënë disa herë po ta them edhe tani, nuk është mirë dështimet e tua mi fokusuar në qeverinë paraprake. Të inkurajojë me ngrit lëndë në hetuesi dhe prokurori edhe në gjitha instancat shtetërore, kush ka abuzu në këtë vend duhet me u ndëshkuar. Te vepra penale qëndrojnë pas asaj çka thash, është vepër penale me projektuar një rrugë e me shtruar një rrugë tjetër. Mos jepni këtu arsye time paushallë, se qeverisja e kaluar

hipotetikusht e paska bë gabim. Nëse ka bë gabim qeverisja e kaluar ti vazhdo me i dërguar lëndët në organet përkatëse. Je i thirrur me bë punën tënde, kështu që mos u merr me qeveri të kalune po merru me punën me çka je ngarkuar. E merr rogen me punu si drejtor me shtru rrugën që ta ka votuar Kuvendi, e jo me shtruar rrugën që nuk ta ka votuar Kuvendi.

z.Reshat Mujota; Te çështja drejtori i DZHE-së te “Mushqerrat” thave kërkesa ka qenë shumë e madhe, a u rrit numri që u shty koha për dhënien e këtyre, a u shty afati për me rrit numrin apo ku janë procedurat. Dhe te çështja te inovacioni tash po e bëjë pyetje se më iku më herët pytja, kisha kërkuar prej drejtoreshës sa punëtorë i ka në staf me ma dhënë një sqarim, në kuadër të kësaj drejtorie, shërbimet të cilat i kryen kjo drejtori edhe sa e ka buxhetin.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Atëherë i nderuar Kryesues dhe të nderuar qytetarë, u be kohë që në adresën time personale po ashtu edhe të drejtorëve, nuk ka seancë që nuk vinë ofendime prej më të ndryshmeve, deri edhe te kërcënimet publike. Edhe një herë po them në emër personal, se kto ofendime i kemi toleruar me idenë që do të përmirësohen, por po ju tregoj se prej sot kushdo që një asambleistë apo asambleiste ofendon publikisht me një fjalor të pa falshëm dhe që nuk i shkon për nder kësaj salle nga unë nuk do të merr përgjigje.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Lista është e njëjtë zotëri Mujota, por bartja ka qenë problem.

z.Grejtalb Emimi, drejtor i DPUGJK; Te taksistët mbeta pa u përgjigjur, i kam takuar disa prej tyre, i takon edhe planifikimit urban me be zgjidhje për taksistët, mendohet që në rrugën “Komandat Kumanova” të jetë një vend stacion për taksistë. Sa i përket disa çështjeve tjera, ne nuk shtrojmë rrugë nëpër Komuna tjera.

znj.Gonxhe Osmani, drejtoresh e Inovacionit; Përhëndetje për të gjithë, Drejtoria e Inovacionit ka buxhet, dhe punëtorë ka vetëm një e nuk janë të vërteta, lajmet që janë tre ose katër, ato janë të planifikuara për vitet e ardhshme, Drejtoria buxhetin e ka 16.200 euro. Është me rëndësi që qendra e Inovacionit është funksionalizuar, dhe tani është në të mirën e qytetarëve. Nëse keni pyetje tjera do ju përgjigjem me email.

Pika 11

Informatë nga DKA për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë shkollor 2023/24

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Fjalën ja dha Yllka Fejzullahut drejtoresh e DKA-së.

znj.Yllka Fejzullahu , drejtoresh DKA; Përhëndetje, DKA i ka bërë përgatitjet e duhura për vitin shkollor 2023-2024. Gjysmë vjetori i parë ka filluar me 1 shtator të vitit 2023 me përjashtim në disa shkolla që kanë qenë në fazat e fundit të renovimeve. Në vazhdim lexoi informatën (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Reshat Mujota; Faleminderit drejtoreshë për informatën, është një informatë në vija të trasha por edhe ka munges të sqarimeve. Ishalla të kanë dëgjuar edhe asambleistët për informatën, që unë të dëgjoja me shumë vëmendje. Drejtoreshë kam do pyetje për ti bërë. Pse nuk po sqarohen edhe sfidat që po kalojnë te procesi Arsimor, kemi pas mungesë te kuadrit për arsim, për hir të korrektësisë nuk dua me i përmend emrat e atyre personave që janë punësuar dhe e kanë lënë procesin e arsimit të pa përfunduar. Gjuhë Angleze, nuk pe përmendi emrin, prej 80 orëve, janë mbajtur vetëm 7 orë në Shkollën e Gjimnazit “Naim Frashëri”. Sfidë tjetër është mungesa e stafit profesional me arsye apo pa arsye nuk e di, kemi informatë që nuk po mbahen orët. Tjetra sfidë është mos reflektimi i tyre edhe pas rekomandimeve, nuk ka reflektim këtu. Vetëm në gjimnazin “Naim Frashëri” drejtoreshë orët e humbura janë 821, këtu është sfidë edhe problem. Çështja tjetër mungesa e kuadrit është mungesë të një koordinatori apo zyrtari administrativ ku drejtoria i kryen edhe punët e administratës. Gjithashtu shkolla tjera e kanë nga një zyrtar administrativ në shkollë. Nuk ceket këtu dëmtimi i shkollës nga huliganët, e kemi pasur një thyrje të shkollës një vjedhje në shkollë të raportohet në Kuvend, është mirë të epet sqarim. Kështu që po pres disa sqarime. I përmende sallat rrethojat, për ata kan kërkuar të rritet buxheti për Arsim. Me të vërtet Arsimi në Komunën tonë është për mjerim. Nuk e di Komiteti për Arsim asnjë rekomandim nuk ka pru as nuk e di kush janë anëtarë të Komitetit, ju vet po thuani Komitetet janë trupa ndihmës të Kuvendit dhe nuk vini me i qitë në Kuvend problemet e shkollave, kështu kisha pas qejf me rrit buxhetin nëpër shkolla me rregulluar

infrastrukturën, si dhe me plotësuar numrin e stafit që mos të kemi neper shkolla humbje të orëve. Edhe një pyetje drejtoreshë, në Gjimnazin "Naim Frashëri" prej fillimit të shtatorit deri në fund të gjysmë vjetorit klasë e dhjeta gjashtë kanë mbet pa Kujdestarë ku ka pasur problem në fund të gjysmë vjetorit edhe me e be mbylljen e notave.

znj.Yllka Fejzullahu, drejtoresh DKA; Reshat falemindertit për pyetjet e shumta, e përmende raportin në baza të pikës së rendit të ditës, ky raport është vetëm për suksesin e nxënësve, për ndryshe nuk e kisha quajtur raport gjashtë mujor po e kisha quajtur raport një vjeçar. Sa i përket humbjes së orëve është e vërtetë që kanë mbetur vetëm gjashtë orë të gjuhës angleze pa mbajtur, e të hapim konkurs vetëm për ato orë është e pa mundur kërkesa për shpallje të konkursit duhet të ketë të paktën 10 orë prandaj nuk na u ka dok e arsyeshme me e bllokuar një numër vetëm, për ato orë, e kemi mbuluar këtë me orë shtesë mes kolegëve me i kompensuar për orë shtesë, i falim nderoj për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin. Tash e tutje në kuadër të buxhetit do të parashihe n edhe këto pagesat për orët shtesë dhe pastaj nuk do të ketë problem lidhur me orët shtesë. E përmende këto vjedhjen Gjimnaz që ka ndodhur, na vjen keq, ne realisht e kemi bërë instalimin kamerave dhe alarmeve neper shkolla . Çështja e kujdestarit ne klasën te Gjimnazi ka pasur disa keqkuptime mes dy arsimtarëve ku tashmë kjo çështje është zgjidhur.

z.Përpraim Ramusa; Drejtoreshë faleminderit për informatën, mendoj informatën qysh ne fillim e nise keq, këtu ke informatë për fillimin e gjysmë vjetorit të parë, e ti dole te investimet kapitale. E ke fillu informatën drejtoresh, DKA ka bërë përgatitjet e duhura për fillimin e gjysmë vjetorit të parë, edhe kjo është gënjeshtër, ku kanë qenë disa shkolla në renovime dhe nuk ka filluar mësimi më kohë. Shumicën e shkollave nuk mbahet mësim , ku vetëm te Gjimnazi 800 orë janë të humbura, por e jotja ka qen me na e sjell informatë për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë. Për ata nuk e ke sjell informatën për këto se del shumë keq . A din drejtoreshë që disa lëndë nuk janë duke mbajtur mësim, i potencojë kolegu paraparak . Qe dy vite e gjysmë fotokopjet nëpër shkolla nuk funksionojnë, e keni sjell vetëm te shkollat e mëdha, ndërsa shkollat e vogla ende nuk funksionojnë. Qe dy vite shkolla e vjetër në Muzeqinë ka mbet në mëshiren e fatit. Pse shkollat nuk janë furnizuar me projektor dhe lloptop, objektet i keni të trashëguar që jua ka lanë qeverisja paraprake, qe dy vite e gjysme asnjë konferencë për arsim se keni mbajtur., nuk ka furnizim të shkollave me tabela smart, tani kërkoni cilësi prej mësimdhënësve, nuk kemi nëper shkolla kabinete te fizikes. Unë nuk e di me këtë qeverisje qysh mundeni me kërkuar cilësi në arsim kur nuk investoni asgjë në arsim, e patët mundësin paraprake të bartja e të hyrave mi dedikuar disa mjete për arsim as që u morën këshilltarët me këtë problematikë. Drejtoresh kërkohet përgjigje për këto që i ceka nëse i ke shkruar.

znj.Yllka Fejzullahu, drejtoresh DKA; Sa i përket informatës, i keni pesë faqe, i keni krejt përpara, ka shifra ka tabela nëse doni me ti lexuar këtu e me mbet këtu një orë. Kështu që mos thuaj që javë kum zhvesh punën e mësimdhënësve, ka shifra përpara, ka grafika ka tabela të cilat nëse i marr i lexoj kemi me mbet këtu deri mbas dite. Mos thuaj që përmenda projektet kapitale, sepse përmenda vetëm ato çka janë për vitin 2024 e që kanë rendësi për qytetarët. Unë u mundova në pika të shkurta me përmbledh, pra është një akuza plotësisht e pa bazë me thanë fole vetëm për projektet kapitale. Tjetra me renovimin e shkollave që ka filluar dhe është e vërtetë që ka pas vonesa. Por arsyeja e kësaj vonese jeni ju opozita, sepse nuk i keni votuar bartjet ku i kemi pasur rreth 30 mijë euro për renovimin e shkollave, dhe kam pritur disa seanca, dhe kjo ka qenë arsyeja e vonesës së renovimeve. Natyrisht që më vjen keq por arsyeja e vonesës jeni ju, nuk e keni marr parasysh kërkesën time, ju kam thënë ju lutem votojeni, sepse kemi me pasur vonesa, nuk ju ka bërë përshtypje, kështu qe mos ejani tash mu ankuar që kemi pasur orë të humbura. Te fotokopjet kemi bërë zgjidhje, është zgjidhje e përkohshme natyrisht, e di që kanë pasur mësimdhënësit probleme po nuk ka munguar vullneti. Te orët e humbura DKA është lis me shumë degë, ka rrethana të ndryshme për humbjen e orëve, ka raste që mësimdhënësit nuk lajmërojnë më kohë që donë më ndërpre mardhën jen e punës, çka të bëjmë me këto raste kanë ta marrim për një kohë të shkurtë, kjo ka ndodhur edhe më herët ku kemi raste te lehonat kur fillon pushimi i lehonisë, kemi raste kur me vonesë na njofton me ndryshuar vendin e punës, të qet në këtë rast para aktit të kryer, ku procedurat e rekrutimit marrin një muaj e gjysmë kohë. Për projektor u ngrit si shqetësim, këtë vit e kam bërë kërkesën në MASHT-ë. Orë të humbura ka pasur gjithmonë edhe do të ketë fatkeqësisht.

znj. Adelina Beqaj; Në lidhje me informatën që na dha drejtoresha, në vend të sqarimeve për shqetësimet e ngritura, unë më shumë pash justifikime. Andaj drejtoreshë kërkojë nga ti që të na sjellësh një raport lidhur me orët e humbura. Në anën tjetër po lidhna te Kryetari i Komunës që nuk deshë mu përgjigjur në pyetje e di që nuk ka përgjigje prandaj nuk don mu përgjigjur. Mu me ka akuzuar Kryetari që nuk e kam votuar Çerdhen në Fshatin Petrovë, atëherë po dua me jua dëshmuar për çka. A mundesh mëmë treguar drejtoreshë saktë, sepse unë e di saktë me na treguar pse ka dështuar projekti i Çerdhes në fshatin Petrovë, nëse ti nuk na tregon atëherë unë po tregoj për hir të qytetarëve se dështimi i projektit të Çerdhes në fshatin Petrovë ka dështuar sepse ju në kërkesën që keni bërë e keni bërë kërkesë në adresë të gabune, ju keni bërë një gabim dhe në vend që të shkruhet Petrovë e keni shkruar Petroviq, prandaj ka dështuar. Kështu që nëse ti ma dëshmon që këtë kërkesë sjellni dokumentin qysh e ke bërë kërkesën, ku për çka që fshati Petroviq nuk e ka mbuluar numrin e nxënësve, ku për këtë arsye ju ka dështuar projekti i Çerdhes në Petrovë, andaj është dashur të shkruhet Petrovë që ata banor ta kenë Çerdhen.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Vetëm pakë se po harrojmë ku jemi, pika 11 Informatë nga DKA për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë shkollor 2023/24, që e dha drejtoresha. Mos e kërkonë fjalën te informata se nuk jua jap fjalën. Keni drejtë më bërë pyetje dhe me marr përgjigje por jo me hy ne replika, se po kaloni tani në personale. Dhe ju kamë thënë edhe prapë po ju them çështjet personale nuk do ti lejojë. Mos lakoni emra as mbiemra tjerë, vetëm kjo informatë është për Drejtorin e Arsimit, çka keni në lidhje me arsimin urdhëroni, përmbliidhni pyetjet e mos mendoni që tri herë për të njëjtën çështje ka me ju a dhënë fjalën, kur e merrni fjalën një herë përmbliidhni gjitha pyetjet jo çka t'ju kujtohet gjatë seancës

znj. Yllka Fejzullahu, drejtoreshë DKA; Zonja Beqa sinqerisht po më vjen keq, nuk e di kush janë personat që të paskan keq informuar, të kisha prit në zyre me u sqaruar.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Ju lutem si ka dy minuta që thash po kaloni në çështje personale, a po vazhdojmë me rendin e ditës apo po e ndërpreme, sepse kështu s'mundemi me vazhduar. Mos tentoni te çështjet personale se nuk ju lejojë. Nëse mendoni se keni ma vazhduar kështu unë e ndërprej.

z. Përpraim Ramusa; Kryesues mos e shkel rregulloren pa ma dhënë fjalën se më takon, mbas përgjigjes së drejtoreshës, në rregullore e ki.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Zotëri Ramusa edhe e kam votuar rregulloren edhe jam kanë ne komision, por nuk shkruan, te informata nuk shkruan. Zotëri Ramusa ka me ta dhënë fjalën veç net kalojnë secili, do ta jap fjalë në emër te grupit por një herë ne ta kryejnë asambleistët tjerë.

z. Muahmet Ademaj; E faliminderojë drejtoreshën për informatën, ju përgëzojë për vullnetin e mirë që e keni për të vendos rregull në shkollat tona. Besoj që edhe drejtorët e shkollave vazhdojnë ta bëjnë një punë të mirë në edukimin e brezit të ri. Fillojmë më numrin e nxënësve që jan regjistruar në klasën e parë, që është shumë shqetësuese numri i vogël nëpër paralele.

Pas problemeve me rrym Kryesuesi e ndërpriti seancën në ora 12:47 dhe vazhdoi në ora 12:53.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Vazhdon aty ku mbete zotëri Ademaj se mendova që e kryet.

z. Muahmet Ademaj; Është shqetësues numri shumë i vogël i nxënësve, në Gjurkoc 3 nxënës, Belinc 7 nxënës ku mesatarja për klasë është 16 nxënës (lexoi raportin). Është mirë që ndërtohen Shkolla e Çerdhe, aneksi i shkollës në Petrovë është i mirëseardhur, në Godanc salla po ashtu.

znj. Adelina Beqaj; Du me replikuar me Muhamet Ademaj ku poe përkrahë keq qeverisjen, ku premtim ka qenë ndertimi i shkollës në fshatin Petrovë e ka përfunduar me një aneks.

z. Muahmet Ademaj; Unë e kam përkrah edhe ndërtimin e shkollës por me sa e di unë dhe Adelina Beqa për aneksin në Petrovë, sa e di unë kjo ka qenë kundër Çerdhes në fshatin Petrovë. Shkolla është mirë aneksi që po ndërtohet nuk kemi pasur mundësi më herët. Çdo investimi duhet të jemi të kënaqur.

znj. Albana Podvorica; Përshëndetje, deshta mu lidh drejtoresh me informatën që keni sjellë në Kuvend, keni pasur takime të shpeshta me drejtorët e shkollave, deshta të di si e vlerësoni punën e tyre si menaxher të shkollave, sa është bashkëpunimi juaj me ata. Në kuadër të kësaj informate nuk pash asnjë aktivitet që është organizuar për nxënësit me nevoja te veçanta. Mendoj së DKA duhet të bëjë planifikime gjithëpërfshirëse, konkretisht të informata që na sjelli në Kuvend të na tregoni çfarë është ndërmarrë lidhur me këtë çështje, duke respektuar parimin gjithëpërfshirës duke respektuar të

drejtat dhe liritë që i kanë të garantuara personat me nevoja të veçanta. Për orët e humbura a do të zëvendësohen, flas për ato që kanë ndodhur për shkak të renovimit të shkollave të na përgjigjet drejtoresha. Nëse me lejohet për replikë, për disa koleg që ngritën çështje për Komitetin për Arsime është funksional, mirëpo ndonjëherë nuk na përgjigjen ftesave drejtorët e caktuar, e mandej jemi të detyruar mi adresuar pyetjet në Kuvend. Gjithashtu për fund edhe siguria nëpër shkolla nuk ceket askund në informatë edhe pse kjo çështje është shumë sfiduese dhe shqetësuese për prindërit që i kanë fëmijët nëpër shkolla. E di që është shumë problematik, por kërkojë një përgjigje edhe për këtë pyetje.

z.Përpraim Ramusa; Nuk e mora fjalën në emër të grupit, po në emër tim. Kisha pas dëshirë mu sjell ti në mënyr të pa kulturuar, sepse je tu e shkel rregulloren.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë kam shumë kulturë, ju shiteni si të kulturuar, maje kulturën për veti urdhëro vazhdoje fjalën.

z.Përpraim Ramusa; Ja po te tregoj se je shumë i pa kulturuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Zotëri Ramusa tu kisha lutur, se nuk te kam as borgj as obligim mem ofenduar, nuk ta kam shkelur drejtën e fjalës.

z.Përpraim Ramusa; Jo po ma përmendi Adelina Beqa emrin nuk ma dhatë fjalën.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Zotëri Ramusa ta kam dhënë fjalën me mirëkuptim urdhëro, nuk shkruan në rregullore që ti gjithë ditën ju me be replik mes veti, urdhëro e ke fjalën vazhdo përfundoje. Leni këto ofendime kultura pa kultura se nuk ja kemi bor gj asnjëri tjetrit. Kurrë në jetën time nuk i kam thënë dikujt qysh po thoni ju tani.

z.Përpraim Ramusa; Drejtoreshë dua me replikuar në përgjigjen tënde, buxhetin për renovim të shkollave qyku Kuvend e ka votuar në 2022 për 2023. Nuk keni ditur me bërë planifikimin, prandaj ju ka shtyrë renovimi. Sikur qysh nuk keni ditur me bërë kërkesën për Çerdhen në Petrovë, e keni shkruar Petroviq. Bëhuni real që ne ta din qytetarët është keq menaxhimin e juaj kur keni bërë planifikimet për renovime prandaj i keni humbur orët mësimore, nuk keni dit me kalkuluar sa pare shkojnë edhe i keni vonuar renovimet.

z.Rexhep Gashi; Drejtoreshë, sot në këtë alokim që u bërë, a janë të mjaftueshme këto mjete të ndara për DKA-në, duke e ditur që në këto shkolla nuk ka ujë të pijshëm, tani thonë aneksi, çka të duhet aneksi pa ujë. Ishte shumë shqetësuese pasqyra e suksesit për këtë gjysme vjetor (lexoi informatën) pse ky rezultat. Unë mendojë drejtorin e keni marrë të trashëguar nga një profesionistë. Besimi i qytetarit na ka pru këtu, qeverisja e kaluar është për mu kritikuar në fund e në krye por edhe ju s'jeni tu be gjë. Unë në fillim ju kam thënë jeni do djem të mirë, merruni me senet konkrete, jo ka ndodh ajo jo kjo tani mos të ndodh, besimi i qytetarit. Qysh ne fillim të gjysmë vjetorit kam munguar 5 profesor, e sipas një informate që kam edhe tani mungojnë, pse nuk keni marr masa, nuk ka profesorë të pa ndërjegjshëm por ka profesorë të interesit, e jo me na u krenuat për një aneks të shkollës 600 mijë euro, por ujë a kanë nxënësit për pije, dy institucionet ma të ndjeshme janë Arsimi dhe Shëndetësia, e të dyja janë të dështuara. Te arsimi nuk dua me laku emra, kërkojë rezultat.

z.Zejnije Valiu; Faleminderit drejtoreshë për informatën, është vërtet shqetësuese numri i orëve të humbura, mirëpo duke e ditur që pushimet mjekësore nuk janë gjithnjë apo rastet të planifikuara, ato vijnë edhe kur nuk priten dhe e dimë që ato orë janë të humbura. Dhe duke e ditur që numri i mësimdhënësve është mbi 300 nxënës dhe nëse vetëm një pjesë e tyre marrin pushim mjekësor të paktën dy ditë ku një mësimdhënës gjatë një dite mendohet të ketë më së pakti 6 ora mësimore, atëherë shifrat janë të larta, mirëpo nga drejtoresha në këtë rast kisha kërkuar që të monitorojë mirë këto pushime mjekësore, ku drejtorët nëpër shkolla ti monitorojnë mirë këtë pushime mjekësore, sepse ndoshta edhe keqpërdoren nga mësimdhënësit, duke ja shtuar edhe këta që 14 mësimdhënës kanë shkuar në pushime të lehonisë. Kërkojë nga DKA që të shpejtojë procedurat e rekrutimit të stafit, që këto vende të zëvendësohen me mësimdhënës të ri dhe procesi mësimor të zhvillohet normalisht. Mirëpo duhet cekur një e mirë për orët shtesë me pagesë, se do të jetë e mirëseardhur, sepse kontrata nënshkruhet me 20 orë por asnjë herë nuk janë paguar, mirëpo në momentin që paguhen besoj që do të bie numri i orëve të humbura. Përveç tjerash edhe te rezultati ku nga niveli i parë deri në të pestën mbi 90 %, në nivelin e dytë 6 deri ne klasën e 8 janë 78 %, kurse ne nivelin 8 deri në 12 janë 48.49 %. Unë nuk mundem me thënë këtu se a është vlerësim real apo jo real, mirëpo

duhet ta dimë që është gjysmë vjetori i parë, mësimdhënësit e përdorin atë metodën që ta ndëshkojë që në gjysmë vjetorin e dytë të tregohet nxënësi ma i suksesshëm. Është kjo një metodë një praktik të cilën e përdorin mësimdhënësit. Nuk po dua me i justifikuar mësimdhënësit as DKA, por rezultati është real, kështu që ata që nuk janë në proces mësimor nuk mundem me ditë.

z.Reshat Mujota; Kësaj here seriozisht dua me mbrojtur Drejtoreshën e Arsimit, ngritën akuza në Kuvend pse janë kaq pak nxënës në klasat e para, kjo drejtoresha nuk ka faj këtu kjo natalitetin s'mundet me javë rrit numrin tash këtu. Këtu nganjëherë folmi, mirëpo te pika e 5 a 6 dalim kundra vetvetes. Sipas statistikave çdo vit ka pasur ramje të numrit të nxënësve. Edhe nuk e zë krenari që tha profa Muhamet Ademaj 600 mijë euro aneks duhet me pas ide tjera që me 29 nxënës me be aneks. Kur pi dëgjojë te orët e humbura tu fol, qe ku e ki profesorin Muhamet Ademaj kush e zëvendëson këtë sot, qe ku e ki edhe ata zonjën atje, se kur kanë mu paguar orët shtesë këta nuk kanë mu kanë në Kuvend këtu tani kam me qenë tu mbajt orë. Këtu a problemi, na kemi probleme me vetveten, këta duhet me ja nis me vetveten, me ja drejtuar gishtin vetes, këto janë problemet që na vet i kemi problemet. Vjen në mbledhje të Kuvendit humb orë atje tani thotë çka janë këto orë mungesë, ku je ti pse s'je në mësim. Ose kanë lidhur atje me drejtorin muhabetin. Kisha pas dëshirë drejtoreshë se më ka ikur kjo pyetje

e pranoj edhe me shkrim te shkolla "Bajram Curri" në fshatin Mollopolc, atje e kem u djeg shkolla e vjetër as nuk ka ndërmarr Komuna asgjë me pastruar, e fëmijët aty po hyjnë tani e mundem mu lënduar. Kisha kërkuar që të jetë dhe me rinovuar atë shkollë, sepse në shkollë në Mollopolc nuk e kemi asnjë kabinet, me rinovuar ose me rrënuar krejt. Po nëse e shihni ju të arsyeshme edhe me rrënuar, banë edhe me rrënuar, po ka disa vlera që kanë mbet si monumente të luftës e nuk kisha pasur qejf me humba ajo vlerë. Ke puna me qit pare aty te bartjet për arsim, askush nuk folke aty, duhet me participuar në arsim për me lulëzuar arsimit. Kisha pas dëshirë që mu marr sa ma shpejt një iniciativë që ajo shkollë mu pastruar ku është një kaos dhe munden që të lëndohen fëmijët. Kështu që bëhuni asamblistë të mirëfilltë, mos u humbni orët e mësimi.

znj.Yllka Fejzullahu, drejtoresh DKA; Ju përgjigjem me shkrim.

Pika 12


Informatë nga DPUKGJ lidhur me legalizimin e objekteve pa leje ndërtimi

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUGJK; Kjo informatë është për ndërtimet pa leje prej viti 2018 deri në fillim të vitit 2024, që janë 107 objekte te legalizume, kemi 47 aplikacione me post nga të cilat 42 janë ta pa kompletuara. Duke u bazuar në të dhënë unë i inkurajoj gjithë qytetarët e Komunës së Shtimes që ta shfrytëzojnë thirrjen për legalizim të objekteve pa leje që i ka rrokur orto foto prej viti 2018 do to thotë si shtëpi banimi si objekt kolektiv, e kanë mundësin mu legalizuar duke u bazuar në ligj. Aplikimet në Komunën e Shtimes janë të vogla, kështu që këtë vit duhet me shfrytëzuar secili nga ne.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishe Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 13:37h

Procesmbajtësi
Shqiprim Hyseni



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

